



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

ISLAMI DHE VARFËRIA

Dr. Jusuf Kardavi

DY FJALË PËR AUTORIN	5
PARATHËNIA E LIBRIT	6
QËNDRIMI I NJERZËVE NDAJ PROBLEMIT TË VARFËRISË.....	9
QËNDRIMI I TË SHENJTËVE NDAJ FUKARRALLËKUT:	9
QËNDRIMI I DETERMINISTËVE (FATALISTËVE):.....	10
QËNDRIMI I THIRRËSVE TË BAMIRËSISË INDIVIDUALE:	11
QËNDRIMI I KAPITALISTËVE:.....	12
QËNDRIMI I BASHKIMIT MARKSIST:.....	14
QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ VARFËRISË.....	15
A. ISLAMI E MOHON QËNDRIMIN E TË SHENJTËVE NDAJ VARFËRISË:	15
B. ISLAMI E URREN QËNDRIMIN E DETERMINISTËVE APO FATALISTËVE NDAJ VARFËRISË	21
C. ISLAMI NUK E APROVON MJAFTIMIN ME MIRËSINË INDIVIDUALE DHE LËMOSHAT VULLNETARE	27
D. ISLAMI E URREN DHE NUK E APROVON QËNDRIMIN E KAPITALIZMIT	28
E. ISLAMI NUK E APROVON QËNDRIMIN MARKSIST.....	30

MËNYRAT (MJETET) E ISLAMIT PËR TRAJTIMIN E VARFËRISË	33
I - PUNA	34
II - KUJDESI I TË PASURVE PËR TË AFËRMIT	44
III - ZEKATI APO LËMOSHA	50
ARGUMENTET KUR'ANORE:.....	64
ARGUMENTET NGA SUNNETI:	65
IV - ASISTENCA E DEPOZITËS ISLAMIKE ME TË ARDHURAT E SAJ TË NDRYSHME	70
V - DETYRIMI I TË DREJTAVE TJERA POS ZEKATIT	71
VI - LËMOSHA VULLNETARE DHE BAMIRËSIA INDIVIDUALE	75
VAKËFI I BAMIRËSISË:.....	78
KONKLUZION	79
MBYLLJE	86
TRIUMFI I ISLAMIT MBI VARFËRINË.....	86

DY FJALË PËR AUTORIN

- U lind në Egjipt më 1926/1344
- Kreu (hifzin) memorizimin e Kur'anit në moshën 10 vjeçare.
- Studioi në El Ez-her nga niveli fillor deri në atë universitar dhe më 1973/1393 mori titullin “Doktor në filozofi”.
- Punoi si hatib, mësues dhe autor në Departamentin e Vakëfeve dhe në El Ez-her.
- Aktualisht është i caktuar për dekan të Fakultetit të Sheriatit dhe Studimeve Islame si dhe drejtor i Qendrës së Studimeve mbi Sunnetin dhe Siren në Universitetin e Katarit. Është anëtar i shumë shoqatave akademike islame etj.
- Ka botuar mbi 42 libra që trajtojnë aspekte të ndryshme të jetës, letërsisë dhe poezisë islame. Midis tyre janë: Fikhu i zekatit; Hallalli dhe harami në Islam; Imani dhe jeta; Fetva bashkëkohore; Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit, etj.
- Artikujt dhe punimet e tij janë botuar në shumë gazeta dhe revista arabe islame.
- Dr. Kardavi konsiderohet si një nga mendimtarët më të moderuar islamë dhe njëri prej atyre që kombinojnë diturinë tradicionale të Sheriatit me një kuptim bashkëkohor të problemeve (Fikh ul

Vâki?)). Shkrimet e dr. Kardavit kanë gjetur një përkrahje të gjerë në të gjitha shtresat e botës islame dhe shumë prej tyre janë përkthyer në gjuhë të ndryshme.

PARATHËNIA E LIBRIT

Këto faqe nuk janë të reja për rregullimin ekonomik në islam, sepse për këtë janë shkruar libra të tjerë më gjërësisht që i përmbajnë ligjet e islamit dhe këshillat e tij të veçanta në lidhje me aktivitetin njerëzor dhe në lidhje me pasurinë, problemin dhe ndërrimin e saj, shpërndarjen dhe konsumimin e saj, dhe dispozitat që janë vendosur për të përmes të cilave erdhi në shprehje drejtësia dhe u realizua baraspesha ndërmjet lirisë së individit dhe interesit shoqëror dhe mes fesë së njerëzve dhe botës së tyre.

Vërtetë studimi e rregullave ekonomike të Islamit është i gjatë e i vështirë, por mua m'u bë e mundur që të punoj disa vite rreth kësaj teme, kur paraqita dizertacionin tim mbi zekatin.

Ndërsa tema ime që po e trajtoj këtu bën fjalë për një pjesë të veçantë dhe ka të bëjë me problemin e varfërisë (fukarallëkut), burimin e saj, ruajtjen e të drejtave të të varfërve, sigurimin e nevojave të tyre dhe ruajtjen e nderimit të tyre në shoqërinë islame nën hijen e sheriatit islam.

Njerëzimi e një varfërinë (fukarallëkun) që në kohët e lashta, fetë dhe filozofitë u munduan që ta zgjidhin këtë problem për një kohë, me anë të këshillave, nxitjeve dhe frikësimeve, p.sh.

shembulli më i qartë për këtë është republika e Platonit disa shekuj para lindjes së Isasë (a.s.) që dëshironte të kuronte një devijim real me një devijim më të madh se ai e më të dëmshëm.

Dhe për këtë është e obligueshme për çdo njeri që ka dituri për fenë islame që t'ua qartësojë muslimanëve realitetin e asaj që e dërgoi Muhammedi (sal-All-llahu alejhi ve sel-lem) si udhëzim dhe mëshirë.

Ato që kemi paraqitur këtu nga trajtimi i islamit për problemin e varfërisë jemi munduar ta kthejmë atë në rrënjën e tij në burimet e tij islame, të cilat janë: Libri i All-llahut dhe Sunneti i të Dërguarit të Tij dhe thënjet e imamëve të zellshëm nga fukahatë e islamit.

Në mënyrë që të mos na akuzoj neve ndonjë njeri partiak për këtë, sepse ne u paraqesim njerëzve një islam të cilin e njohën sahabët dhe e kuptuan atë Ebu Hanife dhe Malik e të tjerë imamë.

Do t'i bëhet e qartë lexuesit në këto faqe që qëndrimi i Islamit ndaj varfërisë dhe burimi i tij, mënyrat që i zgjodhi ai për burimin e tij, kujdestaria e tij ndaj të drejtave të të varfërve, donatorizimi i tij për nevojat e tyre materiale dhe edukative etj, e bën atë medhheb (rrugë-drejtim) që dallohet nga çdo medhheb tjetër.

Vërtetë islami ka qëndrimin e tij ndaj jetës, njeriut, punës, pasurisë, individit dhe kolektivit, i kundërshton plotësisht të gjitha qëndrimet e medh'hebeve të tjera, qoftë të djathtë apo të majtë: ai mban qëndrimin e tij të veçantë dhe të pavarur as i lindjes e as i perëndimit, por edukative dhe njerëzore: All-llahu xh.sh. thotë:

“All-llahu është dritë (ndiçues, udhëzues) i qiejve e i tokës. Shembulli i dritës së Tij i gjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët. Kandili gjendet brenda një qelqi si të ishte yll flakërues

e që ndizet prej (vajit të) një druri të bekuar, prej ullirit që nuk mund të quhet as i lindjes e as i perëndimit, e vaji i tij ndriçon pothuajse edhe pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë. All-llahu udhëzon kah drita e Vetë atë që do Ai. All-llahu sjell shembuj për njerëzit. All-llahu çdo gjë di shumë mirë.”

(Nur: 35)

Le të lëmë për islamit dhe origjinën, rrënjën e tij dhe përsosshmërin, thellësinë, barazpeshën e tij dhe të thërrasim tek një islam i vetëm me plot bindje e guxim si shëruesi i të gjitha problemeve tona dhe zgjidhësi i nyjeve tona dhe vetëm ai është ilaç sepse parimet tjera dhe organizatat tjera janë mashtruese dhe përhapin mashtrimin për çdo sëmundje, ndriçimi i çdo errësire, dhe se çka janë të tjerë parime e organizata të cilat përhapin mashtrimin dhe edhe vetë janë mashtrues.

E ato nuk janë tjetër veçse iluzione të humbura dhe imagjinata të kota dhe provime të ngelura dhe na mjafton neve se ato janë nga prodhimet e çifutëve të ndyrë dhe punime të jobesimtarëve mashtrues.

“E veprat e atyre që nuk besuan janë si valët (nga rrezet e diellit) në një rrafshinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t’i afrohet atij nuk gjen asgjë, por aty e gjen All-llahun dhe Ai do t’ia japë llogarinë e tij. All-llahu është i shpejtë në llogaritje. Ose (veprat e tyre) janë si errësitat në det të thellë të cilin e mbulojnë valët mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit All-llahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë.”

(Nur: 39-40)

Dr. Jusuf Kardavi

QËNDRIMI I NJERZËVE NDAJ PROBLEMIT TË VARFËRISË

Që në kohët e lashta njerëzit kanë pasur qëndrime të ndryshme ndaj problemit të varfërisë, të cilat do t'i bëjmë të qarta në vijim.

QËNDRIMI I TË SHENJTËVE NDAJ FUKARRALLËKUT:

Prej tyre një grup asketësh, murgjish dhe sufistësh pretendojnë se varfëria nuk është sherr që të kërkohet shmangia e tij ose largimi nga ai, dhe as sëmundje që kërkon kurim, por se është begati e All-llahut që Ai ia jep atij që do Ai, nga robërit e tij, në mënyrë që zemra e tij të jetë e lidhur me ahiretin, duke i refuzuar mashtrimet e dunjasë, e të jetë i lidhur me All-llahun, mëshirues me njerëzit, në të kundërtën e pasurisë e cila të çon në humbje dhe arrogancë.

Prej tyre ka që thonë: Kjo botë është prishje dhe dunjaja është sherr dhe bela dhe se, më e mira e të mirave do të ishte shpejtimi i shkatërrimit të saj ose, më së paku shkurtimi i qëndrimit të njeriut në të, prandaj duhet për të mençurin largimi nga kënaqësitë e dunjasë dhe mosmarrja pjesë në të përveç sa çka i mundëson atij jetesën në të.

Në fetë hyjnore janë gjetur thënie dhe thirrje që e madhërojnë varfërinë dhe e shenjtërojnë atë, sepse ai është mjet për dënimin e trupit dhe dënimi i trupit është mjet për lartësimin e shpirtit, dhe u përhap edhe tek disa sufistë muslimanë, të cilët u ndikuan nga kulturat e huaja, të cilat e

njolllosën kulturën islame dhe e turbulluan kthjelltësinë e saj, si sufistët indianë dhe murgjit katolikë e tjerë.

Ende vazhdoj ta kujtoj një tekst, të cilin e kam lexuar në librat e tyre: Teksti thotë: “Nëse e shikon varfërinë duke ardhur, thuaj: Mirë se erdhe simbol i njerëzve të mirë, e nëse e shikon pasurinë duke ardhur, thuaj: mëkat që po shpejton dënimi i tij”!!.

Është marrëzi që të kërkojmë nga ky grup njerëzish, i cili e shikon varfërinë në këtë pikëpamje, dhe paraqesin zgjidhjen për këtë problem, ndërkohë kur as që e konsiderojmë varfërinë si problem real.

QËNDRIMI I DETERMINISTËVE (FATALISTËVE):

Ky grup e kundërshton grupin e mësipërm në qëndrimet e tyre ndaj varfërisë. Ata mendojnë se në të ka sherr dhe bela, por thonë se ai është caktim nga qielli, s’ka të bëjë me të doktrina, mjekësia dhe as ilaçi, pra, fukarallëku i të varfërit dhe pasuria e të pasurit, janë në dëshirën e All-llahut të Lartësuar dhe në caktimin e Tij, e sikur të donte All-llahu, do t’i kishte bërë të gjithë njerëzit të pasur dhe do t’i kishte dhënë çdo njerit prej tyre thesarin e Kur’anit, por Ai dëshiroi që të ngrejë disa prej tyre në gradë më të lartë se të tjerët. Ai begaton shumë atë që do dhe nuk begaton gjithashtu atë që do, në mënyrë që t’i sprovtojë ata në atë ç’farë iu ka dhënë.

Ilaçi të cilin e paraqesin këto për problemin e varfërisë monopolizohet në këshillën e tyre për të varfërit që të kënaqen me caktimin (e All-llahut), të bëjnë durim nga belatë dhe të binden me atë ç'farë u është dhënë, sepse bindja është thesar i pafund... dhe bindja tek ato është kënaqësi aktuale, në çdo gjendje që të jetë.

Ky grup “El-xhebrije” nuk kujdeset për të pasurit dhe për pasurinë e tyre që e shpenzojnë, që t’u drejtojnë atyre një këshillë, por ai ua drejton këshillën e tij të varfërve: Ky është caktimi i All-llahut për juve, të jeni të kënaqur me të, e mos kërkonit gjë tjetër më lart se kjo, e mos u mundoni që ta ndryshoni atë.

QËNDRIMI I THIRRËSVE TË BAMIRËSISË INDIVIDUALE:

Kemi nje grup të tretë i cili i bashkangjitet grupit të dytë në të gjitha pikëpamjet e tij lidhur me varfërinë. Ata mendojnë se në të ka sherr dhe bela, gjithashtu e konsiderojnë atë problem që kërkon zgjidhje. Por se në zgjedhjen e këtij problemi nuk mjaftohen me këshillën e tyre ndaj fukarave me kënaqësi dhe bindje si grupi i dytë, por bëjnë edhe një hap para duke këshilluar të pasurit me dhënien e sadakasë dhe bamirësisë, dhe u premtojnë atyre shpërblimin tek All-llahu, nëse i përgjigjen kësaj thirrjeje bamirësie dhe ua tërheqin vërejtjen duke ua kujtuar atyre përfundimin e keq dhe dënimin me zjarrin e xhehennemit nëse i keqtrajtojnë të varfërit.

Kjo është ajo pikëpamje me të cilën u dalluan fetë e mëparshme nga Islami; mbështetja në bëmirësinë individuale dhe lëmoshat vullnetare, urrejtja e pikëpamjes së mendimeve shënjtërore

dhe xhebrije, të cilat kanë qenë mbizotuese në shumë njerëz të feve tjera. Gjithashtu, këto janë ato mendime të cilat mbizotruan Evropën gjatë mesjetës.

QËNDRIMI I KAPITALISTËVE:

Grupi i katërt në lidhje me varfërinë, është i mendimit se varfëria është sherr nga sherret e jetës dhe problem nga problemet e saj, dhe se përgjegjësi për të është vetë i varfëri ose shansi, ose përcaktimi dhe jo populli, as shteti, e as të pasurit. Çdo individ është përgjegjës për vetën e tij, është i lirë në sjelljet e tij dhe i lirë në pasurinë e tij.

Udhëheqësi i këtij grupi është Karuni, që ka qenë nga populli i Musait të cilit i dha All-llahu nga thesaret që nuk i kishte askush. kur e këshilloi atë populli i tij:

“Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mango atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu ty, e mos bën të këqia në tokë, se All-llahu nuk i do çrregulluesit.”

(Kasas: 77)

Përgjigja e tij ishte:

“Ai (Karuni) tha: “Më është dhënë vetëm në saje të dijes sime!” Po a nuk e di ai se All-llahu shkatërroi para tij nga popujt e lashtë asish që ishte edhe më i fuqishëm e më i pasur se ai, po mëkatarët kriminelë as që do të pyeten për fajet e tyre (meqë All-llahu e di).”

(Kasas: 78)

Pasuesit e teorisë së Karunit gjithashtu, mendojnë se, atë që kanë grumbulluar nga pasuria e kanë grumbulluar dhe mbledhur me zgjuarsinë e tyre dhe influencën e tyre dhe se zotëruesi i pasurisë është më meritues për të sesa dikush tjetër, dhe se ai ka të drejtën e sjelljes me atë pasuri si të dojë ai dhe ku të dojë. E nëse ai bën mirë dhe i jep një fukaraje diçka, ai është i zoti i mirësisë dhe i mjafton shoqërisë në shikimin e këtyre që t'iu jepet liria për të gjithë për të fituar dhe për tu bërë të pasur, dhe kush nuk fiton dhe nuk bëhet i pasur, kjo nuk është përgjegjësi e shoqërisë ose e popullit dhe se nuk është e detyruar për të pasurit që të kujdesen për të varfërit dhe të paguajnë për ta, përveçse në aspektin e mëshirës dhe të përfitimit të falenderimeve të dunjasë ose arritjes së sevapit në ahiret për atë që beson në të. Ky koncept është koncepti i veçantë i kapitalistëve i cili zotroi Evropën në fillimin e kësaj kohe.

Nuk është për t'u çuditur se kapitalizmi në fillimin e dukjes ose shfaqjes së tij u njoh për dhunën e madhe dhe egoizmin e tepërt i cili nuk mëshironte të vegjëlit e as femrën, të dobëtin, nuk shikonte me syrin e mëshirës dhe keqardhjes për të varfërin gjë që i detyroi fëmijët dhe gratë që të shkojnë e të punojnë në fabrika me rrogën më të ulët.

Por ky kapitalizëm arrogant dhe diktator u lëkund nën presionin e revolucioneve dhe luftrave dhe përparim luftëra diktatoriale në të gjithë botën.

Kjo bëri që shtresat e dobëta të shoqërisë, pleqët, të varfërit dhe invalidët, të marrin gradualisht të drejtat e tyre, duke arritur që shteti të vendos ligjin e sigurimeve sociale.

QËNDRIMI I BASHKIMIT MARKSIST:

Grupi tjetër, thotë: Vërtetë eliminimi i varfërisë dhe drejtësia ndaj të varfërve nuk mund të plotësohet përveçse me destruksionin e fukarave dhe konfiskimin e parave të tyre dhe ndalimin e tyre nga të ardhurat e tyre nga cila do anë që të vinë. Dhe nuk u mjaftuan thirrësit e kësaj rruge me shkatërrimin e të pasurve dhe konfiskimin e asaj që zotëroni ku shkuan se duhet luftimi i mbretërisë.

Thirrësat e komunizmit dhe socializmit revolucionar i bashkon urrejtja ndaj pronës private, e cila konsiderohet burim i çdo të keqeje dhe si e tillë duhet ndryshuar. Disa prej tyre zgjodhën rrugën e ligjit demokratik, ndërsa disa të tjerë zgjodhën ndërrimin e sistemit me revolucion.

Xhorxh Borxhan dhe Bejar Rambir thonë në librin e tyre “Ky është socializmi”:

Disa thonë: Vërtetë socializmi ka për qëllim lirinë e individëve dhe respektimin e tij. Disa të tjerë përgjigjen. Porse ai është zotrimi i mjeteve të prodhimit për popullin dhe vendosja e diktaturës së proletarjatit.

Ndërsa ne nuk do të ndalemi shumë në këto dialogje violente, sepse këto nuk janë të reja, dhe këtë e vërejtë edhe Maksim Lorova, ku thotë në librin e tij “Zbulimi i Socializmit francez”: S’ka dyshim se socializmat janë të ndryshëm, pra socializmi i Bobofit është në kundërshtim të madh me socialimin e Brudonit. Dhe dy socializmat San Simonit dhe Brudon Tetnizanit janë ndryshe nga socializmi i Blankit, dhe të gjithë këto gjithashtu nuk ecin me mendimet e Luis Blan, Kajih, Farih dhe Bejkurit. Mes gjithë këtyre grupeve nuk gjen gjë tjetër përveçse armiqësi dhe urrejtje. Porse duke punuar së bashku të gjithë këto socializma bashkohen me qëllim të njëjtë që i

rregullon ato dhe i afron mes tyre, eliminimi pronës private, i cili është burim i çdo padrejtësie në shoqëri. Ndërsa socializmi revolucionar ose marksist nuk ka mes tij dhe komunizmit përveçse dallime të pakta, ku të gjithë bazohen mbi shikimin material për jetën dhe njeriun. Të gjithë këto grupe e urrejnë fenë, e shkëpusin atë nga shoqëria dhe bëjnë thirrje për një shtet laik dhe jo për një shtet fetar.

QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ VARFËRISË

A. ISLAMI E MOHON QËNDRIMIN E TË SHENJTËVE NDAJ VARFËRISË:

Islami e mohon dhe e urren qëndrimin e grupit të parë ndaj varfërisë në veçanti dhe ndaj jetës në përgjithësi. Ai i mohon mendimet e sufistëve, të cilët i futën mes muslimanëve kur i morën nga Francezët dhe Indianët, nga murgjërit katolikë nga grupe të tjetra religjioze.

Në librin e All-llahut xh.sh gjenden shumë ajeti të cilat flasin për varfërinë, gjithashtu edhe në fjalët e profetit tonë Muhammedit a.s. përmendet shumë varfëria dhe largimi prej saj.

Islami e konsideron pasurinë begati, të cilën All-llahu ia dhuron robërve të Tij dhe kërkon prej tyre që ta falenderojnë për të. Ndërsa varfërinë e konsideron problem madje fatkeqësi që kërkohet mbrojtje nga All-llahu prej saj. Prandaj vendos mënyra të ndryshme për trajtimin e tij. Mjafton të përmendim këtu, se All-llahu i dha të Dërguarit të Tij pasuri, ku thotë:

“Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi”

(Duha: 8)

Dhe e bëri dhënjen e pasurisë nga shpërblimet e Tija më të shpejtuara për robërit e Tij besimtarë.

“Unë u thashë: “Kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai vërtet falë shumë; Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk. Ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj.

(Nuh: 10-12)

Ndërsa dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) thotë: “Pasuria më e begatshme dhe më e mirë është për njeriun e mirë” All-llahu i Lartësuar i thotë të Dërguarit të Tij për çështjen e shkllëvërve të Bedrit:

“O Pejgamber! Thuaju atyre robërve që i keni në duart tuaja se posa të vërejë All-llahu ndonjë të mirë (besim të drejtë e të singertë) në zemrat tuaja, Ai u jep edhe më shumë të mira nga ajo çka është marrë nga ju, ua falë gabimet, se All-llahu falë pa masë, se është mëshirues i madh.”

(Enfal: 70)

Hadithet e Pejgamberit e konsiderojnë varfërinë gjë të rrezikshme, që është për t’u frikësuar nga ndikimi i saj i keq. Qoftë mbi individin, apo kolektivin në besim, moral, mendim dhe kulturë si dhe mbi familjen dhe të gjithë ummetin, siç do ta cekim më poshte:

Rreziku i varfërisë për besim:

S'ka dyshim se vafëria është nga gjërat më të rrezikshme për besimin fetar dhe në veçanti varfëria ekstreme. Me këtë rast varfëria është thirrës për dyshim në urtësinë e formimit kyjnor të gjithësisë dhe për dyshimin në drejtësinë e shpërndarjes hyjnore për rriskun (furnizimin).

Ky devijim besimi, i cili vjen nga vafëriagjithnjë e në rritje nga keqshpërndarja, ai është që i bëri disa selef të thonë; Nëse shkon varfëria në një vend, i thotë atij kufri (mosbesimi) më merr edhe mua me ty!! Dhunnun Misri thotë: Ndër njerëzit jobesimtarë është një fukara që s'ka durim dhe të paktë janë ndër njerëz durimtar!.

Nuk është e çuditshme që të transmetohet nga i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Gati sa s'ishte fukarallëku kufër (mosbesim).” Dhe nuk është e çuditshme që të kërkojë mbrojtjen e All-llahut nga dëmi i varfërisë të bashkangjitur me kufirin në një drejtim; thotë në hadith: “O Zot, kërkojë mbrojtjen Tënde nga kufri dhe fukarallëku,” dhe thotë: “O Zot, unë kërkoj mbrojtjen Tënde nga fukarallëku dhe paksimi dhe nënshtrimi, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga padrejtësia ime ndaj të tjerëve dhe nga padrejtësia e të tjerëve ndaj meje”.

Rreziku i varfërisë për moralin:

Nëse varfëria është rrezik për besimin gjithashtu nuk është rrezik më i pakët për moralin. Vërtetë i varfëri, shpeshherë, gjen në veten e tij ç'ka e shtyn për të ndjekur atë që nuk e pranon morali, dhe për këtë kanë thënë: “Zëri i stomakut është më i fortë dhe më tinglues sesa zëri i ndërgjegjes”. Edhe Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) e ka bërë të qartë stresin e varfërisë mbi fukaranë dhe ndikimin e tij në moralin: “Merreni atë ç'farë ju dhurohet përderia ajo është dhuratë, e nëse bëhet ryshfet në fe, mos e merrni atë”. Por nuk do ta lëni atë përderisa ju ndalon juve nevoja dhe vafëria!. Në qartësimin e ndikimit të fesë mbi borxhliun thotë: “Vërtetë një

person nëse (nëse e mbulojnë borxhet) merr borxh, flet, gënjen dhe premtion, pastaj e thyen premtimin”. Duke bërë me shenjë lidhje mes varfërisë dhe pasurisë me të mira dhe të këqia, po përmendi hadithin e një burri i cili dha lëmoshë natën një tjetri dhe korrespondoi lëmosha e tij në duart e një hajduti dhe njerëzit filluan të flasin për këtë çështje. Një një herë tjetër i dha lëmoshë një gruaje dhe lëmosha e tij korrespondoi në duart e një lavireje dhe u gdhinë njerëzit duke biseduar për këtë çështje, nërsa i erdhi dikush në gjumë i thoshte: përse i përket lëmoshës tënde që ia dhe hajdutit, shpresojmë se më këtë të shmanget nga hajdutilleku i tij, e përse i përket lëmoshës që ia dhe lavires, shpresojmë që ajo të shmanget dhe të pastrohet nga prostitucioni i saj.

Rreziku i varfërisë për mendimin njerëzor

Varfëria nuk paraqet rrezik vetëm për aspektin shpirtëror dhe moral për njeriun, por përfshin gjithashtu edhe aspektin mendor dhe logjik. Kur i varfëri nuk arrin t'i plotësojë nevojat e jetës dhe familjes së tij, si do të arrijë të mendojë dhe të logjikojë me saktësi, në veçanti nëse fqinji i tij e ka shtëpinë të mbushur plot e përplot me të mira dhe depozitën apo kasafortën e tij të mbushur me ar?! Transmetohet nga Imam A'dham Ebu Hanife se ai ka thënë: “Mos kërko sygjerim nga dikush që në shtëpinë e tij nuk është preciz dhe i rregull” Ndërsa në një hadith të saktë thuhet: “Mos të gjykojë gjykatësi kur është i zemruar”. Fukahatë (dijetarët e jurisipodencës islame) krahasuan me zemrimin urinë e madhe, etjen e madhe e të tjera sikur këto gjëra ndikuese.

Rreziku varfërisë për familje:

Varfëria është rrezik për aspekte të ndryshme të familjes, për përbërjen, vazhdimsinë, përmbajtjen e saj. Pra, në përbërje të familjes e gjejmë varfërinë një nga pengesat më të mëdha, e cila gjindet mes rinisë dhe martesës e çka vjen pas saj me vështirësitë e mehrit, shpenzimit dhe pavarësisë

ekonomike, dhe për këtë Kur'ani i këshillon shokët e këtyre që të kapen pas ndershmërisë dhe durimit, derisa që t'u ipet mundësia ekonomike:

“E ata që nuk kanë mundësi martesë, le të përmbahen derisa All-llahu t'i begatojë me të mirat e veta. E ata që i keni në pronësinë tuaj dhe kërkojnë prej jush t'i lironi në bazë të kompenzimit, atëherë ua bëni këtë të mundshme me marrëveshje, nëse e dini se janë të besueshëm dhe jepnu nga pasuria që u ka dhënë All-llahu juve. Mos i detyroni robreshat tuaja të bëjnë imoralitet, e për shkak të ndonjë fitimi të kësaj bote, derisa ato dëshirojnë të jenë të pastra. E kush i detyron me dhunë të bëjnë atë, All-llahu i falë ato pas atij detyrimi. All-llahu falë dhe është mëshirues.”

(Nur: 33)

Sot shohim disa vajza dhe prindërit e tyre që u paraqitet martesa, e refuzojnë atë për shkak të gjendjes së dobët ekonomike të dhëndërrit.

“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësitë e Tij, All-llahu është bujar i madh, i Gjithëdijshëm.”

(Nur: 33)

Dhe në vazhdimsinë e familjes shikojmë presionin e varfërisë. Ndoshta kjo bëhet shkak për ekzistencën e dhunës mes burrit dhe gruas së tij. Gjithashtu. Edhe gjykatësi e lejon divorcimin e gruas nga burri i saj nëse ai s'është në gjendje të përballojë shpenzimet për të. Edhe në lidhjet mes pjestarëve të vetë familjes, në shumicën e rasteve, e gjejmë varfërinë që e prish kthjelltësinë e tyre, Kur'ani flet për një realitet historik, friksues kur disa prindër i mbytën fëmijët e tyre nga frika e varfërisë dhe ky veprim konsiderohet krim në Islam. All-llahu i Lartësuar thotë:

“Thuaj: “Ejani t’ju lexojë atë që me të vërtetë ju ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi All-llahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu të mendoni thellë.”

(En-’am: 151)

“Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.”

(Isra’: 31)

Pa marrë parasysh që varfëria është realitet frikësues, nuk lejohet të jetë shkak që të kryhet ai krim i urryer dhe gabim i madh, të cilin Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) e përmendi pas shirkut të madh, kur u pyet: Cili mëkat është më i madh? Tha: “T’i bësh shok All-llahut dhe Ai është që të ka krijuar ty”. I thanë: Pastaj cili? Tha: “Të mbytësh fëmijën tëndë nga frika që mos të ushqehet me ty”.

Rreziku i varfërisë për shoqërinë

Dhe mbi gjitha këto, varfëria është i rrezikshëm për sigurinë e shoqërisë. Transmetohet nga Ebu Dhërri që thotë: “Çuditëm me atë që nuk gjen ushqim në shtëpinë e tij si nuk del t’i luftojë njerëzit me shpatën e tij?!”. Njeriu mund të durojë nëse shkak i varfërisë është të ardhurat e pakta dhe shumimi i njerëzve. Por, nëse shkak i tij është keqshpërndarja e pasurisë dhe padrejtësia e disa njerëzve ndaj të tjerëve, ky është ai fukarallëk i cili i nxit gjakrat, sjell përçarje, lëkundje dhe i shkatërron shtyllat e dashurisë dhe vëllazërimit mes njerëzve.

B. ISLAMI E URREN QËNDRIMIN E DETERMINISTËVE APO FATALISTËVE NDAJ VARFËRISË

Ashtu siç e shpalli urrejtjen e tij ndaj qëndrimit të grupit të parë ndaj varfërisë dhe ndalimit material dhe dënimit trupor në përgjithësi, Islami e urren gjithashtu edhe grupin e dytë determinist ndaj varfërisë dhe pretendimin se çështja e varfërisë dhe pasurisë është çështje definitive dhe masë e caktuar. Ajo s'mund të kundërshtohet dhe se pasuria e të pasurit është me caktimin e All-llahut, varfëria e të varfërit është me caktimin e All-llahut dhe caktimi i Tij tregon pëlqimin dhe kënaqësinë e Tij. Le të jetë i kënaqur çdo njeri për gjendjen e tij dhe mos të kërkojë ndryshimin e saj.

Dhe Islami duhej ta plotësonte mesazhin e tij në lirimin e njeriut prej adhurimit të varfërisë, dhe vendosjen e të drejtave individuale për një jetë të lirë e të begatshme, dhe stabilizimin i shtyllave donatore sociale. Duhej për të që të luftonte atë mendim të gabuar deterministësh, i cili u përhap dhe mori rrugën e tij në mendjet dhe zemrat e njerëzve që në kohën e hershme. Erdhi Kur'ani, e gjeti këtë mendim dhe i thirri të pasurit që të jepnin nga furnizimi i All-llahut mbi robërit e Tij, obligoi në pasurinë e tyre që të kenë të drejta lypësit dhe të ngratët (ata që kanë nevojë por nuk lypin). Kur ato u argumentuan me caktimin e All-llahut, iu kundërpërgjigj mendimeve dhe pretendimeve të tyre dhe i hodhi ato në një humbje të hapët dhe të qartë. Për këtë erdhi thënja e All-llahut të Lartësuar:

“Dhe kur u thuhej: “Jepni nga ajo që All-llahu u begatoi, ata që nuk besuan, besimtarëve u thanë: “A ta ushqejmë atë që sikur të donte All-llahu do ta ushqente? Ju nuk jeni tjetër vetëm se të humbur qartë!”.

(Ja Sin: 47)

Një nga parimet më të mëdha që rrënjosi Islami është se çdo enigmë në gjithësi ka zgjidhje dhe për çdo sëmundje ka ilaç, se vërtetë Ai që krijoi, sëmundjen krijoi edhe ilaçin. Pra, sëmundja është me caktimin e All-llahut dhe shërimi është me caktimin e All-llahut. U pyet i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) për ilaçet që të kurohen me to. A kthehet nga caktimi i All-llahut gjë? Ka thënë: “Ato janë prej caktimit të All-llahut”

Pra, nëse varfëria ka qenë sëmundja vërtetë. All-llahu zbriti për të ilaçin... e nëse ka qenë caktim prej All-llahut, edhe çlirimi prej tij është nga caktimi i All-llahut gjithashtu.

Domethënia e bindjes dhe e kënaqësisë me atë që ka caktuar All-llahu:

Ndërsa çfarë ka ardhur në hadithe për nxitjen e bindje dhe kënaqësis për atë ç'farë ka caktuar All-llahu, nuk do të thotë që të varfërit të kënaqën me një nivel të ulët jetese dhe të mos përpiqen për fitimin e pasurisë hallall; nuk do të thotë që të pasurit të lihen ta shpërdorojnë pasurinë me shpenzime ekstravagante për të luajtur e jetuar.

Vërtetë bindja dhe kënaqësia me atë çfarë ka caktuar All-llahu nuk do të thotë asgjë nga ajo çka përmenda, sepse vetë i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) i ka kërkuar All-llahut xh.sh. pasuri, dhe devotshmëri.

Bëri lutje dhe për shokun dhe shërbëtorin e tij, Enesin, “O Zot shtojë pasurinë e tij.”

Çfarë do të thotë bindja atëherë?

Vërtetë ajo do të thotë dy gjëra:

E para sepse njeriu me natyrën e tij është shumë lakmues për dunja dhe nuk ngopet me të. Këtë e bën të qartë hadithi i Pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) ku thotë: “Sikur të kishte biri i Ademit dy lugina me ar, do të dëshironte të tretën dhe nuk e mbush syrin e birit të Ademit përveçse dheu”. Pandaj duhej patjetër për fenë ta udhëzojë atë për drejtësi në vrapimin pas pasurisë dhe në përgjithësi në kërkimin e furnizimit (rriskut). Me këtë feja vendos ekuilibër në veten dhe në jetën e tij, i jep atij qetësi, e cila është sekreti i lumturisë dhe e largon atë nga teprimi, shpërdorimi e ekstravaganca, të cilat e lodhin shpirtin dhe trupin. Dhe nga kjo Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) thotë: “Vërtetë shpirti i shenjtë frymëzoi në zemrën time se as një njeri nuk do të vdesë derisa të plotësojë rrishtun e tij, prandaj frikësojuni All-llahut dhe zbukurojani kërkimin. Dhe sikur të lihej njeriu që t’u dorëzohej disa shtytjeve të lakmisë së tij do të bëhej rrezik për veten e tij dhe atë që është rreth tij. Prandaj duhej patjetër drejtimi i tij në një gradë më të lartë dhe rrisht më të qëndrueshëm. Dhe është detyra e fesë me të:

“Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarë), e për t’i sprovuar me të, sepse shpërbimi i Zotit tënd është më i mirë dhe është i përjetshëm.”

(Taha: 131)

“Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolitur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po te All-llahu është e ardhmja më e mirë.

Thuj: “A t’ju kumtoj për diç shumë më të mirë se ato (kënaqësitë e dunjasë)? Për ata që janë ruajtur, ata kanë te Zoti i tyre Xhennete nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe aty do të jenë përgjithmonë, kanë bashkëshorte të pastra, dhe kënaqësinë e All-llahut. All-llahu është i kujdesshëm për robtë.”

(Imran: 14-15)

Detyra e besimit është që ta drejtojë njeriun në një gradë të lartë shpirtërore dhe të përhershme, në ahiretin e përhershëm, tek All-llahu xh.sh. i cili është i gjallë dhe nuk vdes. Besimtari e di se pasuria nuk është në mbledhjen e parasë dhe shumimin e plaçkave, porse në brendësinë e shpirtit. Për këtë transmetohet në hadith: “Nuk është pasuria në shumimin e plaçkave, porse pasuri është pasuria e shpirtit”.

Ndërsa kuptimi i dytë i kënaqësisë me atë që ta ka dhënë All-llahu xh.sh. është ta dish se ndryshimi i tyre në aftësi dhe talent. Ky ndryshim i dedikohet natyrës së kësaj jete dhe detyrës së njëriut për të përdorur vullnetin dhe dëshirën e tij në sprovat që i zbriti All-llahu xh.sh.

“All-llahu favorizoi disa prej jush mbi disa tjerë në furnizim. Atyre që u është dhënë përparësia (në furnizim), nuk janë furnizues të atyre që posedojnë (robërve), ata (të gjithë) në të janë të barabartë (furnizues kryesor është All-llahu), A mos duan të mohojnë dhuntinë e All-llahut?”

(Nahl: 71)

“S’ka dyshim se Zoti yt është Ai që furnizon me bollëk atë që do dhe ia kufizon atij që do. Ai hollësisht e di për robtë e vet dhe i vështron.”

(Isra: 30)

“Ai është që ju bëri sundues (zëvendësues) në tokë (pas shkatërrimit të atyre që ishin më parë) dhe lartësoi në një shkallë më të lartë disa nga ju mbi të tjerët, për t’ju sprovuar në atë që ju dha. All-llahu është ndëshkues i shpejtë, është që falë e Mëshirues.”

(En’am: 165)

Pra, siç gjejmë ndër njerëz të shkurtër dhe të gjatë, të shëmtuar dhe të bukur, të metë dhe të zgjuar, të dobët dhe të fuqishëm gjithashtu, ka edhe të kënaqur dhe të varfër. Kjo është natyra e jetës dhe natyra e All-llahut, të cilën komunistët nuk arritën ta ndryshojnë. Islami kërkon nga muslimani që të jetë realist, ta pohojë jetën ashtu siç është, dhe mos ta jetojë jetën e tij në pesimizëm dhe në lodhje të përhershme, duke vrapuar pas iluzioneve dhe imagjinatave të rreme. Islami kërkon prej muslimanit që mos të jetë gjëja më e rëndësishme e tij shikimi tek ajo që u është dhënë të tjerëve nga begatitë me një shikim armiqësor, i cili e gëlltitë zemrën e tij me smirë dhe e përvëlton gjoksin e tij me urrejtje. Vërtetë shikimi i njeriut tek ç’ka u është dhënë të tjerëve dhe çka nuk u është dhënë ajo nuk sjell për të përveçse mizerje dhe fatkeqësi. Më parësore është që të shikojë tek ajo që i është dhënë atij nga begatitë e shumta, të shikojë tek ai që është më poshtë, prej atyre që u janë ndaluar të tilla begati dhe të gëzohet e të kënaqet dhe të qetësohet zemra e tij.

Pra, kuptimi i bindjes në këtë rast është që njeriu të kënaqet me atë ç’ka i dhuroi All-llahu, dhe që s’mund ta ndryshoj dot. Kjo, sepse njeriu i janë dhënë aftësi fizike, mendore dhe shpirtërore të caktuara që e drejtojnë, brenda këtyre mundësive duhet të zhvillohen përpjekjet e tij. Ai nuk duhet të jetojë me shpresa e iluzione utopike, si plaku që kërkon të rinohet, e nuk duhet të kërkojë të paarrtshmen, siç kërkuan gratë në kohën e Pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) të kenë ato të drejta që kanë burrat. Prandaj All-llahu zbriti versetin kura’nor:

“Mos lakmoni në atë, që All-llahu gradoi disa nga ju mbi disa të tjerë. Burrave ju takon hise nga ajo që fituan ata dhe grave gjithashtu ju takon hise nga ajo që fituan ato. All-llahut kërkoni nga të mirat e Tij. All-llahu është i dijshtëm për çdo send.”

(Nisa: 32)

Këta kanë nevojë që ta dinë se lumturia nuk është në mundësimin e të mirave materiale të jetës, por në brendësinë e shpirtit. Atyre duhet t’u thuhet:

“Kënaqu me atë çka të ka dhënë All-llahu dhe do të jesh njeriu më i pasur”.

“Ka fituar ai që është udhëzuar në Islam dhe ka qenë rrisku (furnizimi) i tij minimal dhe është bindur me të”.

“E pakta dhe e mjaftueshme është më e mirë se e shumta që të merr mendjen”.

Atëherë bindja është që mos të jesh i lakmueshëm, smirëkeq dhe as shikues tek ajo që nuk është e jotja dhe që s’mund ta kesh dot. Me këtë bëhet më e çlodhshme dhe më e rehatshme jeta, të cilën e bëri All-llahu shpërblim për besimtarët punëtorë dhe të devotshëm në këtë dunja (botë).

“Kush bën veprë të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”

(Nahl: 97)

C. ISLAMI NUK E APROVON MJAFTIMIN ME MIRËSINË INDIVIDUALE DHE LËMOSHAT VULLNETARE

Islami, edhe nëse duket sikur përputhet me mendimin e grupit të tretë në thirrjen që i bën të pasurve për të dhënë lëmoshë, për të bërë vepra të mira, për të ndihmuar të dobët, porse ai e urren dhe nuk e aprovon mjaftimin e tyre me këtë aspekt vullnetar dhe shikon se lënia e të varfërve dhe të dobëve në shoqëri nën mëshirën e të pasurve nuk është gjë tjetër, veçse humbje për to në veçanti nëse ngurtësohen zemrat, dobësohet besimi dhe fiton kopracia dhe egoizmi, siç është ajo shoqëri injorante, të cilës All-llahu iu drejtua në Kur'an në thënien e tij.

“Jo, nuk është ashtu! Por (punoni edhe më zi) ju nuk përfillnit bonjakun. Nuk cytni njëri-tjetrin për ta ushqyer të varfërin. Dhe ju e hani me të madhe trashëgimin (padrejtë). Dhe pasurinë e doni së tepërmi.”

(Fexhr: 17-20)

Kjo mangësi në trajtimin e varfërisë vjenë nga vetë natyra e bamirsisë individuale dhe e lëmoshës vullnetare. Këtë natyrë e analizon prof. Dr. Ibrahim Lebban në një kërkim shkencor të tij për të drejtat e të varfërve, ku thotë: “Bamirësia është parim i dobët në qënien e saj dhe nuk arrin që ta kurojë problemin e varfërisë plotësisht, sepse ajo, nga njëra anë nuk përcaktohet sipas shumës që i përshtatët nevojave të të varfërve në shoqëri dhe nga ana tjetër, ka atë gradë rregullimi që i siguron rregullsinë dhe vazhdimësinë në mbledhjen e saj. Prandaj frytet e saj janë të papërfillshme dhe të parregullta. Ç’farë e ndërlikon më shumë problemin është, se ajo është detyrë individuale, e

lënë në dëshirën e individit, dhe shteti nuk ndërhyt dot dhe të vendos taksa popullit për thënien e saj tek të varfërit e të dobët.

D. ISLAMI E URREN DHE NUK E APROVON QËNDRIMIN E KAPITALIZMIT

Ashtu siç nuk e pranon idenë e mjaftimit me bamirësinë individuale, Islami nuk e pranon as idenë kapitaliste, se njeriu është zotërues i vërtetë i pasurisë së tij, i vetmi që ka të drejta mbi të, që mund të jap ose të mbajë sipas qejfit, që mund ta shpërdorj atë si të dojë. Ky është qëndrimi i Karunit i cili pasurinë e quajti si meritë të vetën dhe e mohoi begatinë që i fali All-llahu; prandaj All-llahu e shkatërroi atë në shtëpinë e tij tokësore:

“Thuaj: “Sikur All-llahu t’a bënte natën të përherhme (t’ua zgjaste) deri në ditën e kijametit, ç’mendoni, cili zot pos All-llahut do t’ju sillte juve dritë? A nuk merrni vesh”

(Kasas: 71)

Vërtetë Islami e mohon këtë qëndrim nga themelet e tij dhe pohon se pasuria është pasuria e All-llahut, Ai është Krijues dhe dërguesi i saj dhe se i pasuri është zëvendësues i mbizotruetit original në kujdesin për rritjen dhe dhënien e saj.

“Besoni All-llahut dhe të dërguarit të Tij dhe jepni nga ajo që Ai u bëri trashëgues në të, se ata që besuan prej jush dhanë për hir të Zotit, ata kanë shpërblim të madh.”

(Hadid: 7)

“E ata që nuk kanë mundësi martese, le të përmbahen derisa All-llahu t’i begatojë me të mirat e veta. E ata që i kenë në pronësinë tuaj dhe kërkojnë prej jush t’i lironi në bazë të kompenzimit, atëherë ua bëni këtë të mundshme me marrëveshje, nëse e dini se janë të besueshëm dhe jepnu nga pasuria që u ka dhënë All-llahu juve. Mos i detyroni robërshat tuaja të bëjnë imoralitet, për shkak të ndonjë fitimi të kësaj bote, derisa ato dëshirojnë të jenë të pastra. E kush i detyron me dhunë të bëjnë atë, All-llahu i falë ato pas atij detyrimi. All-llahu falë dhe është mëshirues.”

(Nur: 33)

“Këta (për të cilët të rrëfyem) janë të dërguarit, disa prej tyre i dalluam nga të tjerët, prej tyre pati që All-llahu u foli, disa i ngriti në shkallë më të lartë, Isait, birit të Merjemës i dhamë argumente dhe e përfocuam me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin). E sikur të donte All-llahu, nuk do të mbyteshin ndërmjet vete ata (populli) që ishin pas tyre, pasi që atyre u patën zbritur argumentet, por ata megjithatë u përçanë. E pati prej tyre që besuan dhe pati të tillë që nuk besuan, e sikur të dëshironte All-llahu ata nuk do të mbyteshin, por All-llahu punon çka dëshiron.”

(Bekare: 253)

Pasuria në dorën e të pasurit, në realitet, është pasuria e All-llahut që i dha atij dhe furnizimi i All-llahut për të. Prej këtu All-llahu i Lartësuar, i cili është Krijuesi i njeriut, krijuesi i pasurisë dhe Krijuesi i Gjithësisë cakton një të drejtë në pasurinë e të pasurve. Dhe nuk mjaftohet Islami këtu thjesht me këshillë, nxitje dhe thirrje për të dhënë lëmoshë, sepse vetëm kjo nuk mjafton nëse ngurtësohen zemrat, sëmuren ndërgjegjet dhe dobësohet besimi, porse ai parashikon edhe ndërhyrjen e shtetit në emër të shariatit, që të marrë nga të pasurit dhe t’u jap të varfërve. Dhe kush refuzon t’i bindet ligjit të All-llahut vrahët luftohet derisa të drejtohet në të drejtë me apo pa

dëshirë. Ajo që i siguron Islamit rezultate të larta është posedimi i disa karakteristikave apo virtyteve që nuk gjenden tek të tjerët:

1. Virtyti apo karakteristika e përparësisë kohore (kohes së hershme): - Vendosi të drejtat e të varfërve dhe i ka luftuar ata që si respektojnë që 14 shekuj më parë.
2. Virtyti apo karakteristika e origjinalitetit: - Këto të drejta të obliguara dhe ligje të detyrueshme nuk janë arnime që janë futur në të, nën presionin e rrethanave, falsifikimeve, revolucioneve e luftrave, porse ato janë parime themelore që konsiderohen nga shtyllat e tij të mëdha.
3. Virtyti apo karakteristika e vazhdimësisë dhe e qëndrueshmërisë: - Vërtetë, ç'farë futet në një regjim apo rregull në rrethana kalimtare mund të ndryshohet apo eliminohet në rrethana të tjera, ndërsa Islami është ligji i All-llahut i përhershëm dhe fjala e fundit e cila nuk pranon fshirje dhe as ndryshim, derisa të përmbysë All-llahu tokën dhe çka ka në të.
4. Virtyti i përsosmërisë dhe gjithëpërfshirjes: - Të cilat nuk realizohen përveçse në rregullat e shariatit të Tij.

E. ISLAMI NUK E APROVON QËNDRIMIN MARKSIST

Ndërsa grupi i fundit janë ata që nuk shikojnë kurim për problemin e varfërisë përveçse në shkatërrimin e të pasurve, marrjen e asaj ç'farë zotrojnë, ndalimin e pronës private dhe ushqyerjen e njerëzve me zjarrin e urrejtjes dhe të armiqësisë derisa të shkatërrohen të gjithë këta dhe të

ngrihet diktatura e proletariatit. Islami e urren qëndrimin e tyre nga themelet, sepse ai kundërshton parimet e tij plotësisht.

1. Nëse gjenden ndër të pasurit njerëz që i shpërdorjnë ato pasuri, u bëjnë padrejtësi të tjerëve dhe hajnë të drejtat e të dobtëve dhe të varfërve, gjen edhe të pasur të tjerë, të cilët e falenderuan për begatinë e pasurisë dhe japin të drejtën e All-llahut dhe të drejtën e njerëzve në të. Nuk lejohet në Islam që të dënohen të gjithë për mëkatin ose për shkakun e disa individëve, sepse çdo njeri është përgjegjës për veten dhe për atë që ka nën kujdes.

“E ata që vetë besuan, e edhe pasardhësit e tyre ishin me besim, Ne atyre do t’ua shoqërojmë pasardhësit e tyre dhe asgjë nuk u pakësojmë nga veprat e tyre (prindërve). Secili njeri është peng i asaj që ka punuar.”

(Tur: 21)

Ky parim ishte edhe në fetë e tjera më të përparshme.

“Apo nuk është informuar me atë që është në fletushkat e Musait. Dhe të Ibrahimit, që gjithnjë i plotësoi obligimet. (Që në to shkruan) Se askush nuk e bartë barrën (mëkatin) e tjetrit. Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar”

(Nexhm: 36-39)

Dhe ky është parim që e aprovon dhe e vendosë çdo mendje e shëndosh dhe çdo shariat i drejtë.

2. Pastaj, Islami e pranon dhe e aprovon parimin e pronës private, sepse në të gjendet plotësimi për nevojën natyrore, njerëzore dhe nxitje për përparimin e shoqërisë dhe lulëzimin e ekonomisë, sepse ajo është siguria materiale për qëndrimin e lirisë qytetare dhe lirisë politike. Po, vërtetë

islami kufizon mbizotrimin individual dhe i vë atij kufij, por nuk është tani momenti që ta shpjegojmë atë, porse ai në përgjithësi e respekton parimin e pasurisë personale, e mbron atë me ligjet e tij dhe e vendosë atë si themel kryesor për regjimin e tij ekonomik. Shfrytëzimi i keq i disa njerëzve i asaj që zotërojnë dhe padrejtësia e tyre në të, nuk do të thotë prishje e parimit të pronës private në qenien e tij, sepse prishja ndodhet në shpirttrat e njerëzve ku nëse do të rregullohen do të bëhet pasuria në duart e tyre vegël apo mjet bëmirësie, dhe për këtë transmetohet një hadith: “Pasuria më e begatshme dhe më e mirë është për njeriun e mirë”.

3. Kjo tregon se Islami i ngre lidhjet mes individëve dhe kolektivit mbi themelin e vëllazërimit dhe bashkëpunimit dhe nuk e aprovon armiqësinë mes individëve dhe kolektivit. Islami e shikon se urrejtja, smira dhe lakmia janë sëmundje që i hanë veprat e mira ashtu siç i ha zjarri drunjtë. Pejgamberi e ka quajtur (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) “sëmundja e popujve”. Si argument për rrezikshmërinë e saj dhe ndikimin e saj të keq.

4. Pastaj Islami, nuk e pranon kurimin e një problemi duke krijuar një problem tjetër, rreziku i të cilit mund të jetë më i madh sesa i pari. Komunistët dhe socialistët mendojnë që ta zgjidhin problemin e varfërisë dhe problemin ekonomik në përgjithësi, me mbyrtjen e lirisë së popullit dhe obligimin e një diktature të ashpër e të përhershme, që kontrollon furnizimin e tij dhe fuqinë e tij dhe nuk iu lejon asnjë shans apo nuk iu krijon mundësi për lirinë e punës ose të pronës personale.

Dhe nuk është për t’u çuditur nëse e gjejmë Kur’anin që thotë:

“All-llahu sjell shembuj: një rob që është pronë e tjetrit e që nuk ka në dorë asgjë, dhe atë, të cilin ne e kemi furnizuar me një furnizim të mirë, ai jep nga ai (furnizim) fshehtas e haptas. A janë pra ata të dy të barabartë? Falënderues qoftë All-llahu, por shumica e tyre nuk dinë.”

(Nahl: 75)

5. Megjithë këtë, si komunistët ashtu edhe socialistët marksistë nuk arritën që me planet dhe programet e tyre të reja të zgjidhin problemin e varfërisë. E nëse është përgjithësimi i varfërisë dhe ulja e nivelit të jetesës diçka e mirë, atë e realizoj komunizmi dhe bija e saj socializmi marksist. Ulja e nivelit të jetës, dhe ndalimi nga të mirat e jetës, është çdo ndjenja e atij që viziton Rusinë, Kinën e të tjera vende si këto nga vendet marksiste. Sekretin në këtë prapambetje prodhime dhe ulje të nivelit të jetesës në vendet socialiste, nuk kthehet tek mos zbatimi i rregullt i socializmit, porse kthehet tek natyra e regjimit socialist, i cili e ndalon pronën shkatërron shpresat dhe motivet individuale dhe nuk i jep vlerë individit në lirinë e prodhimit ose konsumit. Kjo gjë në veçanti të çon në një shkatërrim të prodhimit dhe e bënë atë përherë nën gradën e prodhimit të kapitalistëve, të cilin e ndihmon liria me karburant që nuk shuhet dhe ushqim që nuk ndërpritet.

6. Dhe e fundit: Ne i vërejmë marksistët që në burimin nuk iu dretojnë të dobtëve dhe të varfërve asnjë lloj kujdesi, porse vetëm proletariatit, në mënyrë që t'i kenë si mjete për rrëzimin e regjimit të një shoqërie. Ata ecin në bazë të filozofisë “kush nuk punon nuk ha!”

MËNYRAT (MJETET) E ISLAMIT PËR TRAJTIMIN E VARFËRISË

Islami i shpalli luftë varfërisë dhe ia mbylli asaj çdo rrugë, duke e mbrojtur akiden (besimin), moralin dhe sjelljet nga rreziku, duke ruajtur familjen dhe shoqërinë.

Prandaj, Islami e bëri obligim, që çdo njeriu që jeton në shoqëri t'i krijohen kushtet e një jetese të rregullt, t'i plotësohen së paku kushtet minimale të banimit, ngrënies, pirjes, veshjes dhe ushtrimit të profesionit të tij.

Por ç'është ajo që ia mundëson këtë jetesë individit në shoqërinë Islame? Cilat janë mjetet që zgjodhi Islami për sigurimin e saj? Mjetet janë si më poshtë:

I - PUNA

Vërtetë çdo njeri në shoqërinë islame kërkohet prej tij që të punojë, është i urdhëruar që të ecë në çdo skaj të tokës dhe të hajë prej furnizimit (rriskut) të All-llahut siç thotë All-llahu xh.sh.:

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja.”

(Mulk: 15)

Vërtetë puna është arma e parë për të luftuar varfërinë, ajo është shkaku i parë për të fituar pasuri, ajo është elementi i parë për të ndërtuar tokën, të cilën All-llahu ia dorëzoi njeriut si zëvendës i Tij dhe e urdhëroi atë ta ndërtojë, kur thotë:

“Edhe te (populli) Themud e patëm njërin prej tyre, Salihun, e ai u tha: “O populli im, adhurojeni All-llahun, ju nuk keni zot tjetër pos Tij, Ai së pari ju krijoi nga dheu dhe ju bëri banues të tij,

andaj kërkoni falje prej Tij, dhe shprehni pendim te Ai. S'ka dyshim, Zoti im është afër (me mëshirë), Ai përgjigjet (lutjeve)”!

(Hud: 61)

Islami i kuroi të gjitha sëmundjet vetjake dhe pengesat të cilat i demoralizuan shumë njerëzit nga puna dhe shpjegimi i kësaj është siç vijon:

1. Ka njerëz që refuzojnë punën me preteksin e mbështetjes tek All-llahu dhe pritjen e furnizimit nga qielli. Kjo është gabim sepse mbështetja në All-llahun nuk e mohon punën dhe marrjen e shkaqeve. Simboli i muslimanit është ajo ç'farë i tha Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) një beduini, i cili e la deven e tij të lirë duke iu mbështetur All-llahut, i tha atij: “Lidhe atë, pastaj mbështetiu All-llahut”.

Parulla e muslimanit është “Mbille farën dhe priti frytet nga Zoti”. i është thënë imam Ahmed Ibn Hanbelit ç'farë thua për atë që rrin në shtëpinë e tij ose në xhami e thotë: nuk do të punoj deri sa të më vijë rrishti im? Imam Ahmed i tha: Ky njeri nuk di asgjë për diturinë, a nuk e ka lexuar thënien e Pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Është vendosur rrishti im nën hijen e shtizës sime”.

Vërtetë All-llahu xh.sh. kur e krijoi tokën, zbriti bereqetin në të, dhe vendosi në brendinë dhe në sipërfaqen e saj, bereqetin, begatitë dhe mirësitë e hapura në mënyrë që t'iu mundësojë robërve të tij jetesën në të, siç thotë All-llahu i Lartësuar:

“Ne ju vendosëm në tokë dhe ju mundësuaam jetesën (mjetet për të jetuar), e pak prej jush po falënderoni.”

(A'raf: 10)

“Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.”

(Isra: 70)

“All-llahu është Ai që ua bëri tokën vendbanim e qiellin kulm, dhe ju formësoi, e formën tuaj e bëri më të mirë dhe ju pajisi me të mira. Ky është All-llahu, Zoti juaj, i lartë, pra është All-llahu, Zot i botëve!”

(Gafir: 64)

All-llahu i Lartësuar ju siguroi të gjithë robërve të tij rriskun madje të gjitha krijesave të gjalla që ecin mbi tokë, thotë All-llahu i Lartësuar:

“Nuk ka anjë gjallesë në tokë që All-llahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj, Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas vdekjes). Të gjitha (këto) janë në librin e njohur (Levhi Mahfudhë).”

(Hud: 6)

“All-llahu është furnizues i madh. Ai fuqiforti.”

(Dharijat: 58)

Porse urtësia e All-llahut, e dikton që këto rrisqe apo furnizime të cilat i siguroi, nuk arrihen përveçse me sakrificë.

Prandaj, All-llahu i madhëruar e bëri rriskun rezultat të punës dhe të përpjekjes në skajet e tokës së Tij.

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja.”

(Mulk: 15)

“E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e All-llahut, por edhe përmendeni shpeshherë All-llahun, ashtu që të gjeni shpëtim.”

(Xhuma’: 10)

Ai që përpiqet duke kërkuar mirësitë e All-llahut dhe rriskun e Tij do të jetë prej atyre që e arrijnë atë. Dhe kush i ka mundësitë dhe nuk përpiqet nga përtacia apo dembelizmi është e ditur se do të privohet ajo mirësi dhe ai rrisk.

Transmetohet se Umer ibn Hattabi një ditë pas namazit pa disa njerëz të ulur në xhami me pretekst mbështetjen në All-llah, e rrinin papunuar dhe tha thënien e tij të njohur: “Mos të rrijë asnjëri nga ju dhe mos të përtojë në kërkimin e rriskut e të thotë “O Zot, më jep rrisk” dhe ai e di se qielli nuk hedh as ar dhe as argjend dhe se All-llahu i Lartësuar thotë:

“E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e All-llahut, por edhe përmendeni shpeshherë All-llahun, ashtu që të gjeni shpëtim.”

(Xhuma’: 10)

2. Ka njerëz që e lënë punën me argument përkushtimin në bindjen ndaj All-llahut, ndërprerjen e plotë nga çdo gjë tjetër përveçse nga adhurimi i Tij, për të cilin është krijuar njeriu.

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”

Këta mendojnë se nuk duhet të angazhohet njeriu me asgjë tjetër kundrejt adhurimit të Zotit të tij, dhe se duhet patjetër që për kryerjen e të drejtave të All-llahut të veçohen për adhurim ndaj Tij si murgjët. Këta njerëz i mësoj Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) se nuk ka murgjëri në Isam dhe se puna e dunjasë, nëse saktësohet njeti në të, dhe respektohen ligjet e Islamit, është adhurim në vetvete, dhe se përpjekja e njeriut që të mbaj familjen e tij, t’iu bëjë mirë të afërmëve dhe fqinjëve të tij ose që të bashkëpunojnë në punë të mira është pjesë e xhihadit në rrugën e All-llahut; dhe për këtë All-llahu i bashkangjiti këto dy cilësi në thënien e Tij.

“Zoti yt e di se ti dhe një grup i atyre që janë me ty, kaloni në adhurim më pak se dy të tretat e natës ose gjysmën e saj a një të tretën e saj. All-llahu e di gjatësinë e natës dhe të ditës dhe Ai e diti që ju nuk do mund t’i përmbaheni asaj, andaj u lehtësoi juve, pra falnu duke lexuar Kur’an sa t’ju vijë më lehtë prej namazit. Ai e diti se nga ju do të ketë të sëmurë dhe të tjerët që gjallërojnë nëpër tokë duke kërkuar nga begatitë e All-llahut, e edhe të tjerë që luftojnë në rrugën e All-llahut, pra falnu dhe lexoni sa të jetë më lehtë prej tij dhe kryene me rregull faljen, jepni zekatin, huazoni (jepni sadaka) për hir të All-llahut hua të mirë, se çka të përgatitni për veten tuaj prej të mirave, atë do ta gjeni te All-llahu edhe më të mirë, dhe shpërblim më të madh, e kërkonit falje prej All-llahut, se All-llahu është mëkatfalës, mëshirues!”

(Muzemmil: 20)

Ndërsa Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) thotë në nxitjen për tregti: “Tregtari i drejtë dhe besnik do të jetë (në xhennet) me Pejgamberin, të drejtët dhe dëshmorët”.

Dhe thotë në nxitje për bujqësi dhe mbjellje: “Çdo musliman që mbjell diçka dhe prej tij ha një zog, një njeri ose një kafshë, do të jetë për të sadaka (lëmoshë e dhënë)”.

Dhe thotë në nxitje për prodhim: “Asnjë nga ju nuk ka ngrënë ndonjëherë ushqim më të mirë sesa ai që është fituar nga dora e tij”.

3. Disa njerëz e lënë punën ngaqë e nënvlerësojnë atë, siç ka qenë gjendja e shumë prej arabëve në kohën e injorancës, të cilët e urrenin bujqësinë dhe punën e krahut, dhe kur erdhi Islami i ndërroi këto mendime të gabuara, e ngriti vlerën e punës, ç’farëdo lloj pune që të jetë dhe e urrejti çështjen e mbështetjes tek të tjerët dhe ua bëri të qartë atyre se çdo fitim hallall është punë e ndershme dhe e madhërishme, edhe nëse disa njerëz e shohin si ulje.

Transmeton Buhariu nga Zubejr ibnu’l-Avvam se Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Që ndonjëri nga ju të marrë litarin e tij dhe të mbledhë një krahë dru, ta mbartë atë mbi kurrizin e vet, ta shes e me to, ia bën All-llahu atij jetesën të mundur, është më mirë se të kërkojë tek njerzit pa marrë parasysh a do t’i japin ata apo do t’ia ndalojnë”. Dhe nuk u mjaftua me këtë qartësim teorik, porse u sollti atyre si shembull vetën e tij dhe të Dërguarit e tjerë që ishin para tij, kur thotë: “Nuk ka dërguar All-llahu asnjë Pejgamber përveçse të ketë qenë bari”. Thanë edhe ti o i Dërguari i All-llahut? Tha: “Po ... i ruaja dhentë në malet e Mekkes”. Dhe ka thënë: “Asnjëri nga ju nuk ka ngrënë ndonjëherë ushqim më të mirë sesa ai që është fituar nga dora e tij, dhe Pejgamberi i All-llahut Davudi hante nga fitimet e dorës së tij”.

4. Njerëz të tjerë e lënë punën, sepse ajo nuk iu mundësohet në vendin e tyre, në atdheun e tyre dhe afër familjës, shoqërisë dhe të dashurve të tyre. Ata e urrejnë gurbetin dhe i shmangen atij. Këta njerëz i nxiti Islami për shpërngulje, iu jep guxim që të emigrojnë dhe ua bëri të qartë se toka e All-llahut është e gjërë dhe se rrisi i All-llahut nuk është i kufizuar në një vend dhe në një anë. Thotë i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Shpërnguluni apo udhëtoni, bëhuni të pasur”. Ndërsa All-llahu xh.sh. thotë:

“Kush shpërngulet për hirë të (të fesë) All-llahut, ai gjen mundësi të madhe dhe begati në tokë. E kush del prej shtëpisë si migrues te All-llahu dhe i dërguari i Tij, dhe e zë vdekja (në rrugë), te All-llahu është mëshirues, mbulon të metat.”

(Nisa: 100)

“Zoti yt e di se ti dhe një grup i atyre që janë me ty, kaloni në adhurim më pak se dy të tretat e natës ose gjysmën e saj a një të tretën e saj. All-llahu e di gjatësinë e natës dhe të ditës dhe Ai e diti që ju nuk do mund t’i përmbaheni asaj, andaj u lehtësoi juve, pra falnu duke lexuar Kur’an sa t’ju vijë më lehtë prej namazit. Ai e diti se nga ju do të ketë të sëmurë dhe të tjerët që gjallërojnë nëpër tokë duke kërkuar nga begatitë e All-llahut, e dhe të tjerë që luftojnë në rrugën e All-llahut, pra falnu dhe lexoni sa të jetë më lehtë për tij dhe kryene me rregull faljen, jepni zekatin, huazoni (jepni sadaka) për hir të All-llahut hua të mirë, se çka të përgatitni për veten tuaj prej të mirave, atë do ta gjeni te All-llahu edhe më të mirë, dhe shpërblim më të madh, e kërkonit falje prej All-llahut, se All-llahu është mëkatfalës, mëshirues!”

(Muzemmil: 20)

Transmetohet nga Abdullah ibn Amr se kishte vdekur një person në Medine dhe që kishte lindur në Medine dhe Pejgamberi, fali namazin e xhenazës dhe tha: “Ah, sikur të kishte vdekur në një vend tjetër e jo në vendin e lindjes së tij!”. i thanë: E pse o i Dërguari i All-llahut? Tha: “Vërtetë njeriu nëse vdes në një vend të huaj i matet atij nga vendlindja e tij deri tek vendvarrosja e tij në xhennet”. Dhe duke u bazuar në këto hadithe e të tjera si këto, u përhapen muslimanët e parë në të gjitha skajet e botës, duke e përhapur fenë, duke kërkuar rriskun dhe diturinë, duke luftuar në rrugë të All-llahut.

U pyet një herë Ummu Seleme për shpërndarjen e fëmijëve të saj në lindje e në perëndim, derisa vdiq njëri në një anë e tjetri në anën tjetër. Tha nëna e besimtarëve: “I ndau ata mes njeri tjetrit vullneti”.

5. Njerëz të tjerë e lënë punën dhe përpjekjen në pjesë të tokës duke u mbështetur në marrjen e tij prej zekatit ose lëmoshave të tjera vullnetare, që ua sjellin të tjerët pa lodhje dhe pa vështirësi. Për hirë të kësaj e lejojnë çështjen e shtrirjes së dorës, tjetrit pa marrë parasysh përuuljen që i bën shpirtit të tij dhe humbjes së edukatës, ku edhe pse është i fortë, i shëndoshë dhe i fuqishëm për fitim, lyp, si shumë të tjerë që i vërejmë sot në vendet islame. Këtyre ua bëri të qartë Islami se nuk e përfitojnë zekatin dhe as lëmosha të tjera vullnetare përderisa janë të fuqishëm për ta fituar atë, dhe këtu u thotë Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) atyre dy personave që i kërkuan t’u jepte atyre nga zekati: “Nuk ka pjesë në të për të pasurin dhe as për një të fuqishëm që ka mundësi të fitojë”. i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): thotë: “Nuk është lejuar lëmosha për të pasurin dhe as për atë që është i fuqishëm dhe i shëndoshë në trup”. Për këtë, Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) nuk u dha të drejta të fuqishmëve, përtacëve, në lëmoshat e muslimanëve dhe e bëri këtë që t’i shtyjë ata të punojnë e të fitojnë nga hallalli. Islami

e ka përmendur shpeshherë dhe e ka vërtetuar ndalimin e lypjes së njerëzve dhe ua ka tërhequr vërejtjen që të largohen nga ajo. E transmetojnë Shejhanët (Buhariu dhe Muslim) nga Ibn Umeri, se i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Vazhdon njeriu të lypë, derisa të vijë dita e gjykimit dhe nuk gjendet në fytyrën e tij asnjë copë mish”. Dhe transmeton Muslimi nga Ebu Hureja (r.a.) se i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Kush lyp nga njerëzit pasurinë e tyre për të shumëzuar pasurinë e tij, ai ka lypur thengjij, pastaj lë të pakësohet ose le të shumohet”. Transmeton Ahmedi nga hadithi i Abdurrahman ibn Auf (r.a.) se i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Nuk ka asnjë rob që e hap portën e lypjes, përveçse ia hap atij All-llahu portën e varfërisë”. Transmeton Nisai nga Aidh ibn Amr (r.a.) se një person erdhë tek i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) i lyp atij dhe ai i dha. Pasi që ai e vuri këmbën në pragun e derës, tha i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem), sikur ta dini atë që është në lypje nuk do të kishte shkuar asnjë që të lypte tek tjetri asgjë.

Lypja lejohet në dy raste:

- Që të lypë nga kryetari i shtetit të cilit i është ngarkuar detyra e kujdesjes për nënshtetasit.
- Që të lypë për një gjë, kur është i detyruar dhe ka nevojë.

6. Disa njerëz e lënë punën duke u ankuar dhe duke mos arritur që ta mundësojë një punë për veten e tij, edhe pse ai është i fuqishëm për këtë punë. Kjo ndodh për shkak të ngushtimit të njohurisë së tij për mënyrat e jetesës dhe për shkak të ngushtimit të njohurisë së tij për mënyrën e fitimit. Transmeton As’habu Sunen nga Enes ibn Malik (r.a.) se një burrë nga ensarët erdhë tek i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) dhe i tha Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) atij: “A nuk ke në shtëpinë tënde gjë?” tha: Po. Kam shtrojë që një pjesë të saj e veshim

dhe një pjesë e shtrojmë, kam edhe gotë që pimë ujë me të. Tha: “M’i sill mua ato dyja” ... pastaj i sollti ato të dyja dhe i mori i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) dhe tha: “Kush i blen këto dy gjëra?” Tha një burrë: Unë i blej ato me një derhem. Tha Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) : “Kush tha më shumë se një derhem?” E përsëriti atë dy apo tri herë. Tha një tjetër: Unë i blej ato me dy derhem. Pastaj ia dha atij, mori dy derhemët dhe ia dha ensarit e i tha: “Menjërin nga këto dy derhem blej ushqim dhe çoja familjes sate dhe me tjetrin blej një gomar apo një mjet bartës”. Pastaj lidhi i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) një litar për dorën e tij dhe i tha: “Shko dhe bëj dru e shiti ato dhe mos u kthe tek unë përveçse pas 15 ditësh”. Pastaj shkoi ky burrë dhe bëri atë çka i tha Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) u kthye dhe kishte fituar 10 derhem !! Pastaj me to bleu me disa veshmbathje dhe disa prej tyre ushqim, pastaj i tha i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Kjo është më mirë për ty sesa të vij lypja jote njollë në fytyrën tënde në ditën e gjykimit, sepse lypja nuk u lejohet përveçse tri kategorive të njerëzve: një person që është shumë i varfër ose një person që ka shumë borxh, ose një person që duhet të paguaj gjakun.”.

Në këtë hadith të qartë shohim se Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) nuk dëshironte që ensari të lypte e të merrte nga paratë e zekatit, ndërkohë që ai ishte i fuqishëm të fitonte vetë. Vërtetë Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) nuk e kuroi problemin e lypsit të nevojshëm me ndihmën materiale kohore, siç mendojnë shumë njerëz, dhe nuk e kuroi atë gjithashtu vetëm me këshillë dhe kërkim nga ai që të shkëputet nga lypja, siç veprojnë disa të tjerë. Porse ai e kapi atë për dore në zgjidhjen e problemit dhe kurimin e tij me një mënyrë efektive, e mësoi atë që të përdorë çdo gjë që ka ai dhe fuqitë nëse janë të pakta, e mësoi atë se çdo punë që të sjell një furnizim hallall, është punë e ndershme dhe bujare. Pas kësaj zgjidhjeje të problemit, i dha atij

edhe një mësim teorik të shkurtër dhe të mjaftueshëm në ndalimin për lypje dhe frikësimin nga ajo.

II - KUJDESI I TË PASURVE PËR TË AFËRMIT

Rrënja e ligjin Islam është që çdo njeri të luftojë varfërinë me armën e tij dhe arma e tij është puna. Por cili është mëkati i të pafuqishmëve, të cilët nuk mund të punojnë? Cili është mëkati i grave të veja, të cilave iu kanë vdekur burrat dhe nuk kanë para? Cili është mëkati i fëmijëve të vegjël dhe të moshuarve? Cili është mëkati i të sëmurëve dhe pensionistëve? Cili është mëkati i atyre që i goditën fatkeqësi dhe i penguan nga fitimi? A do të lihen ato nën presionet e jetës që t'i shtrydhë ato, t'i tërheqë zvarrë dhe pastaj t'i lërë pas saj si një leck që e tretë era? Jo... Vërtetë Islami ka punuar për shpëtimin e tyre nga mashtrimet e varfërisë dhe të nevojave, dhe e para çfarë ka vënë në ligjin e tij ka qenë sigurimi i elementeve të një familjeje.

Theksi që vë islami për të drejtat e afrimitetit dhe lidhjet farefisnore

Islami theksoi të drejtat e të afërmeve dhe nxiti në versetet e librit të tij dhe hadithet e të Dërguarit të tij mirësinë ndaj tyre, lidhjen me ta dhe bëmirësinë ndaj tyre; dhe i ka premtuar atij që i ndërpret lidhjet farefisnore të tij ose i keqtrajton të afërmit e tij, e sillet keq me ta, një dënim të fortë dhe nga versetet është thënia e All-llahut të Lartësuar:

“All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”

(Nahl: 90)

“O ju njerëz! Keni frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burrra shumë e gra. Dhe keni frikë All-llahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisën (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.”

(Nisa: 1)

“Adhuronie All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, sillnu mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.”

(Nisa: 36)

“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa rrugë.”

(Isra': 26)

“Andaj, jepja të afërmit atë që i takon, e edhe të varfërit edhe udhëtarit, e kjo është shumë më e dobishme për ata që veprojnë për hirë të All-llahut dhe të tillët janë ata të shpëtuarit.”

(Rum: 38)

Ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) thotë: “Kush beson në All-llahun dhe ditën e gjykimit, të mbajë lidhjet e tij farefisnore të tij”. “Afërsia e gjakut varet në Arsh dhe thotë: Kush i

mban lidhjet me mua, All-llahu do t'i mbajë me të, ndërsa kush i ndërpret lidhjet me mua, All-llahu do t'i ndërpresë lidhjet me të". Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) e bëri obligim mirësjelljen ndaj prindërve dhe të afërmeve kur thotë: "Sillu mirë me nënën tënde dhe me babain tënd, motrën tënde dhe vëllaun tënd... janë të drejta të detyruara dhe mbajini lidhjet farefisnore". Gjithë këto tekste janë argumente se, të afërmit ndaj njëri-tjetrit kanë të drejta më shumë se për të tjerët, për shkak të atyre lidhjeve farefisnore që kanë mes tyre.

E nëse do të thonin disa se qëllimi në këto tekste është mirësjellja dhe lidhja pa detyrim do të thuhet duke iu kundërpërgjigjur se All-llahu i Lartësuar i ka urdhëruar, dhe i ka quajtur ato të drejta. Dhe Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) na lajmëron se ajo është e drejtë dhe obligim.

- Nuk ka kuptim për lidhje farefisnore pa shpenzim për të nevojshmit: Nese thuhet se qëllimi i të drejtës së tij është mosndërprerja e lidhjeve me të, përgjigja është siç ka thënë Ibnul Kajjim:

Pika e parë: Ç'farë ndërprerje është më e madhe se ta shikojë duke vdekur nga uria dhe etja dhe nuk e ushqen atë qoftë edhe një kafshatë, nuk i jep të pijë atij qoftë edhe një gllënjë dhe nuk e vesh atë me çka e mbulon avretin e tij që ta mbrojë atë nga i nxehti dhe të ftohtit? E gjithë kjo ndodh ndërkohë që ai është vëllai i tij ose djali i xhaxhait të tij ose djali i tezës së tij! E nëse nuk është kjo ndërprerje atëherë ne nuk e dimë se cila është ndërprerja e ndaluar e lidhjes që urdhëroi All-llahu?!

Pika e dytë: Cila është ajo lidhje e detyruar të cilën nxitën tekstet? Ç'farë mase është e tepërt në të për të drejtat e një të huaji dhe si të kuptojnë me zemrat e tyre?

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) i bashkangjiti të drejtat e vëllait dhe të motrës me ato të babait dhe të nënës, kur thotë: “Sillu mirë me nënën tënde dhe me babain tënd, motrën tënde dhe vëllain tënd, e pastaj me të afërmin e më të afërmen”.

Udhëzimi i të Dërguarit të All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) është korrespondues i Kur’anit, dhe e gjithë kjo është komentim i fjalës së All-llahut:

“Adhuroni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.”

(Nisa: 36)

“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa rrugë.”

(Isra’: 26)

“Andaj, jepja të afërmit atë që i takon, e edhe të varfërit edhe udhëtarit, e kjo është shumë më e dobishme për ata që veprojnë për hirë të All-llahut dhe të tillët janë ata të shpëtuarit.”

(Rum: 38)

All-llahu i Lartësuar i bëri të drejtat e të afërmeve menjëherë pas të drejtave të prindërve, ashtu siç i bëri edhe Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem). E nëse nuk është ajo e drejtë për shpenzim, atëherë nuk e dimë se çfarë e drejte është. All-llahu i Lartësuar urdhëroi për bëmirësi ndaj të afërmeve dhe nga keqbërjet më të mëdha është që ta shohë atë duke vdekur nga uria dhe

etja ndërkohë që ai ka mundësi që ta ndihmojë atë. Ky ligj i Pejgambërit (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) është korrespondues i librit të All-llahut të Lartësuar ku thotë:

“Vazhdoni rregullisht namazet (faljet), e edhe atë namazin e mesëm, dhe ndaj All-llahut të jeni respektues (në namaze).”

(Bekare: 238)

Kushtet e detyrimit të dhënies apo të shpenzimit për të afërmit: Fukahatë kanë kushtëzuar dy kushte për detyrimin e shpenzimit për të afërmit:

a) Varfëria e atij që shpenzohet për të.

b) Ai që shpenzon pos asaj që shpenzon për të varfërin t'i mbesë shpenzim edhe për familjen e tij.

Ç'farë përfshinë shpenzimi?

Islami nuk e ka përcaktuar këtë shpenzim të cilin e ka obliguar për të varfërin me një kufi apo cak të caktuar, sepse nevojat e tyre ndryshojnë me ndryshimin e vendit, gjendjes, kohës dhe traditës, gjithashtu edhe ato që shpenzojnë ndryshojnë fuqitë e tyre të pasurisë. All-llahu i Lartësuar thotë:

“Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngusht nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë All-llahu, e All-llahu nuk ngarkon askë, vetëm aq sa i ka dhënë; mirëpo pas vështirësisë All-llahu sjell çlirim (begati).”

(Talak: 7)

“Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjidhënien, janë të obliguara t’u japin gjë fëmijëve të vet dy vjet të plota. i ati i fëmijës është i obliguar për furnizim dhe veshmbathjen e tyre (gruas) ashtu si është rregull. Askush nuk ngarkohet më tepër, vetëm aq sa ka mundësin e tij. Asnjë nënë nuk bën të dëmtohet me fëmijën e saj, e as babai me fëmijën e tij. Po ashtu është i obliguar edhe trashëgimtari (i fëmijës). E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi (prindërit) shfaqin dëshirën për ndërprerjen (më herët) e gjinit, nuk është ndonjë mëkat për ta. Nëse ju baballarët për fëmijën tuaj dëshironi gjidhënese tjetër me kusht që pagesën t’ia bëni në mënyrë të duhur, nuk është ndonjë mëkat. Kini frikë nga All-llahu dhe dine se All-llahu sheh çka punoni.”

(Bekare: 233)

“Nuk është mëkat për ju nëse i lëshoni gratë pa pasur kontakt (martesë) me to dhe para se t’u caktoni atyre ndonjë caktim (kurore-nikah), po pajisni ato (me ndonjë pajisje), pasaniku sipas mundësisë së tij dhe i varfëri sipas mundësisë së tij. Një pajisje e zakonshme është obligim për bëmiresit.”

(Bekare: 236)

Dhe kanë thënë fukahatë se shpenzimi përmban këto gjëra:

Ushqimin dhe pijen,

Veshmbathjen për dimër dhe verë me atë që i përshtat secilës nga to,

Vendbanimi dhe mobiljet,

Shërbëtori për atë që s'arrin t'i shërbejë vetes së tij,

Martesa e atij që dëshiron të martohet,

Shpenzimi për bashkshorten dhe familjen e tij.

Shpenzimi për të afërmit nga veçoritë e Islamit: Islami ka vendosur tullën e parë në ndërtimin e asistencës sociale dhe nuk ishte ajo çështje e pëlqyer, por e drejtë që All-llahu urdhëroi për dhënien e saj ashtu siç u përmend më sipër.

III - ZEKATI APO LËMOSHA

Përse u obligua zekati (lëmosha). Islami ka urdhëruar çdo të fuqishëm që të punojë e të vrapojë në kërkimin e rriskut në mënyrë që të mjaftojë vetën e tij e të pasurojë familjen e tij ose të japë në rrugën e All-llahut, dhe kush nuk mundet dhe është i pafuqishëm për punë, nuk ka pasuri, qoftë edhe nga pasuria e trashëgimisë ose nga ajo e ruajtur që t'i mbulojë nevojat e tij, hyn në kujdesin e të afërmeve të tij të pasur që e ngrejne atë dhe i bëjnë ballë çështjeve të tij. Porse, jo çdo i varfër ka të afërm të pasur që shpenzojnë për të. Ç'farë të bëjë ai i cili nuk ka të afërm të pasur që ta mbartin atë e ta marrin çështjen e tij? Ç'farë të bëjnë të nevojshmit si shembulli i një fëmije jetim, i një gruaje të vejë, i një nëne plakë dhe i një të moshuari? Ç'farë të bëjë i verbëri, i sëmuri dhe invalidi? Ç'farë të bëjë i fuqishmi, i cili nuk ka gjetur punë që të furnizohet nga ajo? ... Ose ç'farë

të bëjë punëtori, i cili e ka gjetur punën, porse ai fitim që merr nga puna nuk i mjafton për vetën dhe familjen e tij?

A do të lehen të gjithë këta në dorën e varfërisë dhe të nevojës, dhe shoqëria t'i shikojë ndërkohë që në të gjenden të pasur dhe askush nuk jep për ta, qoftë edhe më të voglën ndihmë!

Vërtetë Islami nuk i ka harruar këta njerëz. All-llahu u ka obliguar atyre të drejta në pasuri e të pasurve dhe obligim të vendosur, i cili është zekati dhe qëllimi i parë i zekatit është pasurimi i të varfërve me të.

Të varfërit e të dobëtit janë të parët që e meritojnë dhënien e zekatit, derisa edhe Pejgamberi (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) në disa qëndrime të tij nuk ka përmendur vetëm këto cilësi, sepse ai është qëllimi i parë si urdhër i tij kur e dërgoi Muadhin në Jemen që ta marr zekatin nga të pasurit e tyre e ta kthejë atë tek të varfërit e tyre. Derisa edhe Ebu Hanife dhe shokët e tij janë të mendimit se zekati nuk i jepet askujt përveçse të varfërve.

Zekati i pasurisë është burim i madh për kurimin e varfërisë:

Zekati nuk është një burim i vogël, sepse ai është dhjetshja ose gjysma e të dhjetëshes nga arritjet bujqësore, qoftë fruta, pemë apo perime duke u bazuar në përgjithësimin e thënies së All-llahut xh.sh.:

“O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që u dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranoni për vete vetëm symbyllas. E, dine se All-llahu s’ka nevojë për ju, është i Madhëruar.”

(Bekare: 267)

Dhe në përgjithësimin e thënies së Pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Në atë që e lag shiu nxirret dhjetëshja, e në atë që ujitet me ndonjë mjet ose me krah, gjysma e dhjetëshes”.

Dhe krahasohen me të sot, në kohën tonë, edhe ndërtesat e fabrikat etj... të cilat përbëjnë një shumë të madhe parash. Zekati, gjithashtu, është një e katërta e dhjetëshës së parave dhe e pasurisë tregtare, pra 2.5 % nga paraja ose tregtija e çdo muslimani që e zotron masën ligjore, nëse nuk ka borxh dhe është më tepër sesa nevojat e tij personale.

Zekati ka të njëjtën masë afërsisht edhe në pasurinë e bagëtive, të cilat përdoren për shumim apo për mjelje si deveja, lopa dhe delja, me kusht që ta mbushin masen e caktuar dhe të kulloten në një vend të lejuar.

Zekati i fitrit:

E gjithë ajo që përmendëm më sipër ishte për zekatin e pasurisë, por ne kemi edhe zeqatë tjetër që është i obliguar për njerëzit dhe jo për pasurinë. Ai është zekati i fitrit, të cilin Islami e bëri ligj, për plotësimin e agjërimit të Ramazanit dhe ardhjen e Bajramit, dhe nga urtësia e ligjerimit të tij janë dy gjëra:

E para: Zëvendësimi i asaj që mund të ketë ndodhur gjatë agjërimit të agjëruesit nga fjalët dhe punët e kota.

E dyta: Nderimi i të varfërve dhe bërja e tyre të ndjejnë se shoqëria muslimane kujdeset për ta dhe vëllëzërit e tyre kujdesën për ta edhe në ditën e Bajramit dhe bashkangjitet e tyre në gëzim me ta.

Thotë Ibën Abbasi: “Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) e obligoj zekatin e fitrit si pastrim për agjëruesin nga fjalët dhe punët e kota e boshe dhe ushqyerje për të varfërit e të dobëtit”.

Ky obligim vjetor ka veçori karakteristike:

Ai është taksë për njerëzit dhe personat siç e bëm të qartë më sipër dhe jo për pasurinë.

Ai nuk është obligim vetëm për të pasurit që zotrojnë masën e caktuar të zekatit, por e obligoi atë i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) për çdo musliman, i lirë apo rob, mashkull apo femër, i pasur apo i varfër, përderisa ky i varfër e zotron para më tepër se nevoja e tij dhe e familjes së tij për natën e Bajramit. Qëllimi i Islamit nga kjo është ushtrimi i muslimanit për dhënie dhe shpenzim, hapurazi ose fshehurazi, dhe bërja e dhënies gjë të zakonshme tek ai, që të jetë dora e tij e lartë që jep edhe nëse është i nevojshëm nga ata që meritojnë zekatin e vitrit sepse ai jep nga njëra anë dhe merr nga ana tjetër.

Ai nuk është vetëm për atë musliman që e ka mbushur moshën, porse për vetën e tij, për familjen e tij dhe për të gjithë ata që janë nën mbikqyrjen apo nën kontrollin e tij.

Islami e bëri masën e tij të pakët, në mënyrë që të arrijë e të mund që të japë shumica, dhe këtë masë e kufizoi Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) me një pangj hurma ose rrush të thatë ose grurë dhe në krahasim me këtë është edhe ushqimi, të cilin e përdorin banorët e atij vendi, ndërsa pangja është e barabartë sot me.176 kg me peshën e grurit. Transmetohet se Umer ibën Abdul-Aziz, Hasan e të tjerë e jepnin sadakan e fitrit, para, sipas vlerës së ushqimit dhe ky është edhe medh’hebi i Ebu Hanifës. Dhe shpresojmë që kjo të jetë më e dobishme për të varfërit sot,

në kohën tonë, dhe ajo që kërkohet me shariat është pasurimi i të varfërit dhe ai realizohet me para më shumë se me asgjë tjetër.

Vendi i zekatit në Islam:

Nga mrekullitë e kësaj feje, nga argumentet se ajo është prej All-llahut dhe se ajo është mesazhi i fundit dhe i përhershëm është se ajo që herët u kujdes për kurimin e problemit të varfërisë dhe kudesin ndaj të varfërve, pa ndonjë revolucion prej tyre dhe pa kërkesa të ndonjë individi apo kolektivi për të drejtat e tyre. Dhe nuk ishte kujdesja e tij sipërfaqëore, por ka qenë nga veçoritë e themeleve të tij nga rrënja e origjinës së tij dhe nuk është çudi që të jetë zekati shtylla e tretë e Islamit, një nga shtyllat dhe simbolet e tij më të mëdha dhe një ndër katër adhurimet e tij. Në hadithin e Ibën Umerit, i cili është i njohur e është mutefekun alejhi, Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Islami është ndërtuar me pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguar i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit, kryerja e haxhit për atë që ka mundësi”. Ndërsa Kur’ani e konsideroi zekatin, pas pendimit nga shirku dhe faljes së namazit, si rrugë të hyrjes në fenë Islame, të realizimit të vëllazërisë islame dhe futjen e tij në radhët e shoqërisë. Ka thënë All-llahu i Lartësuar për mushrikët:

“E kur të kalojnë muajtë e shenjtë, luftoni idhujtarët kudo që t’i gjeni, robëroni dhe ngujoni ata, e vinju pritë në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, e falin namazin dhe e japin zekatin, atëherë ua lëshoni rrugën, se vërtet All-llahu falë është mëshirues.

(Tevbe: 5)

“Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zekatin, atëherë i keni vëllezër në fe. Ne sqarojmë agumentet për ata njerëz që kuptojnë.”

(Tevbe: 11)

Nuk realizohet për një qafir të pafe hyrja në radhet e muslimanëve dhe vendosja e vëllazërimit të tyre fetar me të, përveçse me pendim nga shirku dhe çka e pason atë si falja e namazit, e cila është një lidhje fetare sociale mes muslimanëve, dhe dhënja e zekatit, e cila është një lidhje pasurie sociale mes tyre. Mënyra e Kur'anit Famlartë dhe sunnetit të pastër është që t'i bashkangjisin namazit zekatin përherë, që është argument për fuqinë e lidhjes mes tyre dhe se Islami i njeriut nuk plotësohet përveç se me to. Namazi është shtylla e fesë, kush e kryen atë e ka ngritur fenë, kush e lë atë e ka shkatërruar fenë. Zekati është baza e Islamit. Kush i përmbahet atij është i shpëtuar dhe kush e neglizhon atë është i shkatërruar. Thotë Abdulla ibën Mesud (r.a.): “Jemi urdhëruar me faljen e namazit dhe dhënien e zekatit dhe kush nuk e jep zekatin nuk ka namaz për të”. Dhe Xhabiri në një transmetim nga Zejdi thotë: “Janë obliguar namazi dhe zekati së bashku nuk është bërë dallim mes tyre dhe lexoi.”

“Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zekatin, atëherë i keni vëllezë në fe. Ne sqarojmë agumentet për ata njerëz që kuptojnë.”

(Tevbe: 11)

Refuzoi që ta pranonte namazin, përveçse me zeqatë dhe thoshte: “All-llahu e mëshiroftë Ebu Bekrin për ato që ka ditur dhe ka kuptuar; dhe kishte për qëllim me këtë thënien e Ebu Bekrit: “Pasha All-llahun! Do t'i luftoj ata që bëjnë dallim në mes namazit dhe zekatit”. Kur'ani e bëri dhënien e zekatit nga cilësitë e besimtarëve bëmires e të devotshëm dhe e bëri ndalimin e saj nga

veçoritë e hipokritëve dhe mushrikëve. Ai është prova e besimit dhe dëshmia e sinqeritetit, siç transmetohet në hadith të saktë: “Sadakaja (lëmosha) është dëshmi. Ai është elementi ndarës apo dallues në mes Islamit dhe kufrit, mes devotshmërisë dhe imoralitetit. Pa dhënien e zekatit nuk futet në radhët e besimtarëve, të cilëve All-llahu iu siguroi shpëtimin dhe trashëgimin e Firdejsit dhe u dha udhëzim dhe përgëzim”. All-llahu xh.sh. thotë:

“Është e sigurtë se kanë shpëtuar besimtarët: Ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, dhe ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë), dhe ata të cilët rregullisht e japin zekatin,”

(Mu'minun: 1-4)

“Janë udhërrefyës dhe myzhde për besimtarët. Që falin namazin dhe e japin zekatin dhe mu ata janë të bindur ndaj botës tjetër.”

(Neml: 2-3)

Pa dhënien e zekatit nuk hyn në grupin e besimtarëve të udhëzuar në librin e All-llahut dhe për të cilët ka thënë:

“E që janë udhëzim e mëshirë për ata që janë punëmirë. Të cilët rregullisht e falin namazin dhe japin zekatin dhe ata, e mu ata janë të plotbindur për botën tjetër (Ahiretin).”

(Llukman: 3-4)

E pa dhënien e zekatit nuk do të jetë nga bëmirisit e sinqertë e të devotshëm, thotë All-llahu xh.sh.:

“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, peygamberëve dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmve, bonjakëve, të vërfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zekatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.”

(Bekare: 177)

Pa dhënien e zekatit nuk arrijnë të dallohen mushrikët të cilët i përshkroi All-llahu me thënien e Tij.

“Thuaj: “Unë jam vetëm njeri sikurse edhe ju, mua më shpallet se Zoti juaj është vetëm Zoti një, pra drejtonju Atij dhe kërkon falje prej Tij. Për idhujtarët është mjerim i madh, të cilët nuk e japin zekatin dhe mu ata e mohojnë botën tjetër.”

(Fussilet: 6-7)

Pa dhënien e zekatit nuk arrinë të dallohet nga hipokritët, të cilët i përshkroi All-llahu në librin e Tij:

“Mospranimin e dhënieve të tyre nuk e pengoi tjetër gjë vetëm pse ata mohuan All-llahun dhe të dërguarin e Tij, dhe namazin e falin vetëm me përtaci, e lëmshën nuk e japin ndryshe pos duke urrejtur.”

(Tevbe: 54)

“Hipokritët dhe hipokritet janë si njëri tjetri; urdhërojnë për të keqen e ndalojnë nga e mira dhe shtrëngojnë duart e tyre. Harruan All-llahun (nuk i binden), prandaj Ai i harroi (nga mëshira). Nuk ka dyshim, hipokritët janë ata të prishurit.”

(Tevbe: 67)

Pa dhënien e zekatit nuk meriton mëshirën e All-llahut, të cilën refuzoi Ai, që t’ia japë përveçse besimtarëve të devotshëm dhe që e japin zekatin, thotë All-llahu i Lartësuar:

“Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në dunja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti. Ai (Zoti) tha: “Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët i ruhen (mekateve), e japin zekatin dhe për ata që argumentet tona i besojnë.”

(A’raf: 156)

Pa dhënien e zekatit nuk e meriton miqësinë e All-llahut e as të Dërguarit të Tij e as të besimtarëve, thotë All-llahu xh.sh.:

“Mik (i afërt) juaji është vetëm All-llahu, është i dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namazin dhe japin zekatin duke bërë rukuë (duke qenë respektues).”

(Maide: 55)

Dhe pa dhënien e zekatit nuk e meriton ndihmën e All-llahut, të cilën ua premtoi atyre që e ndihmuan rrugën e Tij.

“(U lejuan të luftojnë) Ata, të cilët vetëm pse thanë: “All-llahu është Zoti ynë!” u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte. E sikur All-llahu të mos i zbrapste disa me disa të tjerë, do të

rrënoheshin manastirët, kisha, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut. E All-llahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se All-llahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues. (Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zekatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve.”

(Haxhixh: 40-41)

Islami i premtoi një dënim të ashpër në dynja dhe në ahiret çdo njeriu që nuk e jep zekatin. E sa i përket dënimit në ahiret, thotë All-llahu i Lartësuar duke i kërcnuar ata që mbledhin pasurinë dhe nuk e japin nga ajo të drejtën e All-llahut.

“O ju që besuat, vërtet një shumicë e parisë fetare e jehudive dhe e të krishterëve, në mënyrë të paligjshme e hanë pasurinë e njerëzve dhe pengojnë të tjerët nga rruga e All-llahut. Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin për rrugën e All-llahut, lajmëroji për një dënim të dhëmbshëm. Atë ditë kur ajo (pasuri e deponuar) fërgohet në prushin e xhehennemit, e me të (ashtu zharavë) lyhen ballët, anët dhe shpinat e tyre (do t’u thuhet): “Kjo është ajo që e depozituar për veten tuaj, pra shijoni atë që e depozitonit!”

(Tevbe: 34-35)

Transmeton Buhariu nga Ebu Hureje nga i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) se ka thënë: “Kujt i jep All-llahu pasuri dhe nuk e jep zekatin e saj, do t’i vijë atij në ditën e gjykimit një gjarpër i madh me dy koka, që e lidh atë dhe e godet. Pastaj e kap për dy nofullave të tij dhe i thotë: Unë jam pasuria jote, unë jam thesari yt”. Pastaj Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) lexoi versetin.

“Ata, të cilët bëjnë koprraci me atë që nga të mirat e veta u dha All-llahu, të mos mendojnë kurrresi se ajo është në dobi të tyre. Jo, ajo është në dëm të tyre. Ajo e mirë me çka bënë koprraci, në ditën e kijametit do t’u mbështillet në qafën e tyre. All-llahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka, All-llahu është i njohur mirë më atë që veproni.”

(Ali Imran: 180)

Ndërsa për sa i përket dënimit të kësaj dunjaje, thotë Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Nuk ka një popull që ta kenë ndaluar zekatin përveçse i ka goditur ata All-llahu me thatësi dhe uri”. Në një hadith të tjetër thuhet: “Nuk ka një popull që ta kenë ndaluar zekatin nga pasuria e tyre, përveçse u janë ndaluar atyre pikat e shiut nga qielli dhe mos të ishin kafshët nuk do të binte shi”. E gjithë kjo është në dënimin hyjnor të caktuar, por kemi edhe një denim tjetër të kësaj dunjaje, i cili është denimi i ligjit Islam dhe të cilin e marrin përsipër kompetentët e shoqërisë Islame. Për këtë denim fletë hadithi i Pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) për zeqatë ku thotë: “Kush e jep atë duke kërkuar shpërblim (nga All-llahu) ai do të marr shpërblimin e tij dhe kush e ndalon atë unë do ta marr atë dhe gjysmën e pasurisë së tij. Ky është vendim nga vendimet e Zotit tonë, dhe nuk i lejohet asnjërit nga familja e Muhammedit (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) të marrë diçka nga ai”. Në këtë hadith lejohet për kompetentin që të marr gjysmën e pasurisë tek ai që e ndalon dhënien e zekatit. Ky është një nga llojet e dënimeve të pasurisë, të cilën e vendos gjykatësi në rast nevojë, në mënyrë që ta edukojë mosdhënësin e zekatit, e kjo nuk është dënim i domosdoshëm dhe i përhershëm. Nuk mjaftohet dënimi i mosdhënësit të zekatit me gjobën e pasurisë, porse e lejon për kompetentin që të përdorë dënimin trupor, sipas interesit dhe nevojës. Më shumë se kjo është Islami që me ligjet e tij, bëri ngritjen e shpatës ndaj atyre që nuk japin zekatin, e për këtë i luftoi halifja i parë, Ebu Bekri dhe shumë sahabë të tjerë, me të ata që nuk

dhanë zekatin, dhe ai e ka thënë fjalën e tij të njohur: “Pasha All-llahun do t’i luftoj ata që bëjnë dallim mes namazit dhe zekatit, sepse zekati është e drejtë e pasurisë...”. Të gjithë këto tekste na vërtetojnë gradën e besimit të lartë. Nuk është vetëm një detyrë e thjeshtë, porse ajo është një nga pesë shtyllat apo bazat mbi të cilat është ngritur ndërtesa islame. Dhe nëse është kjo grada apo vendi i obligueshmërisë së zekatit me sheriatin Islam, Këtë e kanë përsëritur edhe dijetarët se kush e mohon obligueshmërinë e tij është bërë qafir (jobesimtar) dhe ka dalë nga Islami, ashtu siç del shigjeta nga harku. Ibën Kudame thotë: “Kush e mohon obligueshmërinë e tij nga padituria, dhe kanë qenë shkaqet e paditurisë ose islami i ri tek ai, ose sepse ai është rritur në një fshat të largët nga qyteti dhe nuk i është bërë e ditur atij obligueshmëria e zekatit, nuk gjykohet si qafir, sepse ai ka shkak. E nëse ka qenë musliman dhe është lindur në mes muslimanëve të ditur, atëherë ai është renegat dhe gjykohet me ligjet e renegatëve dhe kërkohet nga ai që të pendohet tri ditë e nëse nuk pendohet vritet sepse argumentet e obligueshmërisë së zekatit janë të qarta në Kur’an dhe sunnet dhe në bashkimin e ummetit, e nëse e mohon atë nuk është gjë tjetër përveçse përgënjeshtrimi i tij ndaj librit dhe sunnetit”.

Zekati është e drejtë e caktuar:

Zekati në këndvështrimin e Islamit është e drejtë ose borxh që rëndon mbi supet e të pasurve për grupet e dobëta dhe që e meritojnë. Ai është gjithashtu e drejtë e caktuar d.m.th. e llogaritur se kujt duhet që t’i jipet ajo, dhe ai i cili e vendosi këtë të drejtë dhe e përcaktoi atë, është All-llahu i Lartësuar, i cili i përshkruajti të devotshmit dhe bëmirësit nga robërit e Tij me thënien e Tij:

“Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por nuk lyp).”

(Dharijat: 19)

Në një sure tjetër i përshkruajti të zgjedhurit nga robërit e tij, të cilët e meritojnë këtë nderim në xhennetin e Tij ku thotë:

“Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë në një pjesë të caktuar. Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp.”

(Me’arixh: 24-25)

Zekati nuk bie si obligim me vdekjen e zotruarit të pasurisë, por nxirret zekati nga ajo pasuri që ka lënë, edhe nëse nuk e ka lënë porosi i vdekuri, ky është mendimi i Ata Hasan, Zuhri, Katade, Malik, Shafiut, Ahmed, Is’hak, Ebi Theurit, dhe Ibni Mundhir. Dhe ky mendim është i saktë duke u bazuar në thënien e All-llahut.

“All-llahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimisë) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra; nëse janë (trashëgimtare) vetëm femra, dy e më shumë, atyre ju takojnë dy të tretat e pasurisë që trashëgohet; nëse është një femër, asaj i takon gjysma; për prindërit, për secilin nga ata, ju takon e gjashta nga ajo që ka lënë (i vdekuri) nëse ka fëmijë, e në qoftë se (i vdekuri) nuk ka fëmijë e atë e trashëgojnë (vetëm) prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta, në qoftë se ai (i vdekuri) ka vëllezër, nënës së tij i takon vetëm një e gjashta, (kjo e drejtë në trashëgim bëhet) pasi të kryhet (vasijeti) që ka lënë dhe pasi të lahet borxhi, ju nuk dini se kush është më afër dobisë suaj, prindërit tuaj ose fëmijët tuaj. (Ky përcaktim është) Urdhër nga All-llahu. Vërtet All-llahu është më i Dijshmi, më i Urti.”

(Nisa: 11)

All-llahu xh.sh. i përfshiu të gjitha borxhet, dhe zekati (siç ka thënë Ibn Hazmi) është borxh ndaj All-llahut, të dobtëve, të varfërve dhe ndaj të gjithë atyre që i ka përmendur All-llahu në Kur'an. Madje Ibn Hazmi është i mendimit se borxhi i zekatit është më parësor se ai i njerëzve dhe argumentohet në hadithin që e transmeton Muslimi nga Ibn Abbasi, që thotë: “Erdhi një person tek i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) dhe tha: Vërtetë nëna ime ka vdekur dhe ajo kishte një muaj të Ramazanit pa agjëruar, a ta agjëroj unë në vendin e saj? Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) i tha: “Sikur të kishte pasur nëna jote një borxh, a do ta kishte dhënë për të? Tha: Po. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) i tha: “Pra borxhi i All-llahut është më parësor që të jepet apo të shlyhet”. Nga kjo bëhet e qartë se, vdekja e një të obliguari për të dhënë zekatin nuk e hedh poshtë atë, dhe se zekati duhet të jipet për të edhe nëse ka qenë vdekja e tij në luftë apo si dëshmorë në rrugën e All-llahut. Dhe si argument është hadithi që e transmeton Muslimi nga Ibn Umeri se i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “I falet dëshmorit çdo mëkat përveç borxhit”.

Përgjegjësia e shtetit mbi çështjet e zekatit:

Zekati, siç na u bë e qartë, është e drejtë e vendosur dhe e caktuar.

“All-llahu caktoi obligim që lëmosha (zekati etj.) t’ju takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhet përfiturat zemrat (të dobtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve), në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet.”

(Tevbe: 60)

Porse ai nuk është e drejtë që i lihet në dorë e individëve ta kryejnë apo jo! Jo, kurrsesi ajo nuk është bëmira individuale, por organizim social, për të cilin kujdeset shteti dhe merr përsipër një trup zyrtar i organizuar.

ARGUMENTET KUR'ANORE:

Argumenti më i qartë për të është thënia e All-llahut të Lartësuar:

“All-llahu caktoi obligim që lëmosha (zekati etj.) t’ju takojnë vetëm: të varfëre (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhet përfiturat zemrat (të dobëtve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve), në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet.”

(Tevbe: 60)

“Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta. All-llahu dëgjon dhe sheh.”

(Tevbe: 130)

ARGUMENTET NGA SUNNETI:

Është hadithi i Ibn Abbasit, i cili është i njohur në Sahihejn (Buhari dhe Muslimi) se, Pejgamberi (sal-llahu alejhi ve sel-lem), kur e dergoi Muadhin në Jemen, i tha: “Mësoju atyre se All-llahu xh.sh. ka obliguar lëmoshën që merret nga të pasurit e tyre dhe kthehet tek të varfërit e tyre...”

Argumenti në këtë hadith qëndron tek ajo se për të marrë zekatin caktohet një person i veçantë, dhe kjo për ta ndarë atë po ashtu, nuk lidhet në zgjedhjen apo dëshirën e atij që i është obliguar lëmosha. Këto argumente të Kur’anit dhe të hadithit na bëjnë ne që të kuptojmë dhe të bindemi që në sheriati islam, shteti islam merr përsipër çështjen e zekatit.

Cilëve të varfër dhe të dobët (të ngratët), u ipet zekati:

Kur’ani u kujdes dhe i kushtoi rëndësi çështjes së dhënies së zekatit, më shumë sesa nxjerrjes apo marrjes së tij, sepse marrja e pasurisë mund të jetë më e lehtë nga organet kompetente me mënyra të ndryshme, por ajo që është e vështirë në realitet është dhënia e tij atyre që e meritojnë dhe vënia e tij në vendin e duhur. Për këtë, Kur’ani nuk e la caktimin e dhënies së zekatit në dëshirën e udhëheqësit, porse i qartësoi ata persona që e meritojnë atë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ka prej tyre që do të bëjnë vërejtjen në ndarjen e lëmoshës, nëse u jepet nga ajo, ata mbesin të kënaqur, e nëse nuk u jepet, ata hidhërohen.

(Tevbe: 58)

“All-llahu caktoi obligim që lëmosha (zekati etj.) t’ju takojnë vetëm: të varfëre (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhet përfiturat zemrat (të dobëtve

në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve), në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet.”

(Tevbe: 60)

Dhe transmeton Ebu Davudi se, një person erdhi tek i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) dhe i tha: “Më jep mua nga lëmoshat. i tha atij i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Vërtetë All-llahu nuk është i kënaqur me gjykimin e një Pejgamberi dhe as të një tjetri me lëmoshë derisa Ai gjykoj vetë me të dhe e pjesëtoi atë në 8 pjesë, e nëse ti je nga ato pjesë do ta jap ty të drejtën tënde”.

Nuk ka pjesë në zeqat një i fuqishëm që mund të punojë e të fitojë

Është detyrë dhe e obligueshme për çdo të fuqishëm që ka mundësi të punojë, që të punojë e ta bëjë sa më të lehtë rrugën për punë. Me këtë e mjafton veten e tij dhe e ruan nderin e fytyrës së tij. Në një hadith të saktë transmetohet: “Asnjë njeri nuk ka ngrënë ndonjëherë ushqim më të mirë sesa ai që e fiton me dorën e tij”. Për këtë e shikojmë të Dërguarin e islamit që thotë duke u shprehur qartë: “Nuk i lejohet sadakaja (lëmoshë) një të pasuri dhe as një të fuqishmi e të shëndoshë”.

Pra, nxjerrim konkluzion se, çdo i fuqishëm për të fituar nga ai me sheriat që të punojë në mënyrë që të mbajë veten e tij. Ndërsa kush nuk është i zoti që të punojë për shkak të dobësisë së trupit të tij si, fëmija, femra, pleqtë, ose nga antikapia dhe sëmundja, ose është i fuqishëm që të fitojë, porse nuk gjen dot një mënyrë për të fituar hallallin ose e ka gjetur, por nuk është i mjaftueshëm fitimi i tij për veten dhe për familjen e tij, këtu i është lejuar atij marrja nga zekati dhe nuk është

turp për të në fenë e All-llahut. Këto janë parimet e fesë Islame, të cilat grumbulluan mes drejtësisë dhe bëmirësisë apo humanizmit, mes drejtësisë dhe mëshirës, ndërsa parimi i materialistëve që thonë: Kush nuk punon nuk ha, ai është një parim jo natyror dhe jomoral dhe jonjerëzor, madje edhe tek shpendët dhe kafshët ka lloje të ndryshme që i fuqishmi nga ato e mbart të dobëtin dhe kujdeset për të.

Ai që është i ndarë dhe i vetmuar vetëm për adhurim nuk merr nga zekati.

Një nga idetë më të mira në këtë çështje është ajo që, kanë përmendur fukahatë (dijetarët e jurisipodencës islame), kur thanë se, nëse njeriu është i fuqishëm për të fituar dhe vetmohet për adhurimin e All-llahut me namaz, agjërim e të tjera si këto, nuk i jepet nga zekati, sepse ai është i urdhëruar që të punojë e ta kërkojë atë në pjesët e tokës dhe nuk ka murgjëri në Islam dhe në këtë gjendje, puna është nga adhurimet më të mira, nëse është i sinqertë në nijet (qëllim) dhe i respekton kufijtë apo dispozitat e All-llahut.

Ai që vetmohet apo që i përkushtohet kërkimit të dijes merr nga zekati:

Ndërsa, nëse njeriu vetmohet ose i kushton çdo gjë kërkimit të dijes së dobishme, atij i jepet nga zekati aq sa i mjafton që të kryejë detyrën dhe plotëson nevojat e tij. Si kjo janë edhe librat e dijes, të cilët duhen patjetër për interes të fesë, dhe dunjasë së tij. Nxënësit të dijes i jepet zekat sepse kryen një farz (obligim) kifaje dhe se dobia e dijes së tij nuk i kthehet vetëm tek ai, por tek gjithë ummeti, prandaj i takon të ndihmohet nga pasuria e zekatit.

Sa i jepet të varfërit dhe të ngratit nga zekati:

Në masën e dhënies së zekatit për të varfërin dhe të ngratin kemi dy mendime apo dy medhhebe: Mendimi (medhhebi) i parë: Dhënia të varfërit atë që i mjafton për tërë jetën: Mendimi (medhhebi) i dytë: i jepet sa i mjafton për një vit.

Martesa nevoj që duhet plotësuar nga zekati.

Është fantastike dhe e mrekullueshme me të vërtetë që dijetarët Islam, të tërheqin vëmendjen se, ngrënja, pirja dhe veshmbathja, nuk janë vetëm këto nevoja të njeriut, por në brendësinë e njeriut ka instikte të tjera që duhen plotësuar. Nga këto është instikti i seksit, të cilin e bëri All-llahu kamxhik që e drejton njeriun në realizimin e dëshirës hyjnore në ndërtimin e tokës dhe qëndrimin e llojit njerëzor deri kur të dëshirojë All-llahu. Islami nuk e përjashton këtë instinkt, por e rregullon atë që të ecë sipas urdhërit të All-llahut, dhe i vë kufijtë. Islami ka ndaluar imoralitetin dhe ka urdhëruar për martesë atë që ka mundësi: “Kush ka mundësi që të martohet nga ju le të martohet, sepse ajo është më mirë që të mbyllet sytë dhe më ruajtëse për organet gjentiale”. Nuk është për t’u çuditur nëse thonë dijetarët, se nga plotësimi i nevojave është ajo që i merr i varfëri për martesë.

Librat e dijës nga nevojat

Islami është fe që e respekton mendjen, thërret për dituri dhe ngre lart gradën e dijetarëve. Dija konsiderohet çelësi i besimit dhe argumenti i veprës apo punës:

“(A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimet të) botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e

Zotit të vet? Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”

(Zumer: 9)

“Nuk janë të barabartë i verbëri dhe ai që sheh. Dhe as errësitat e drita.”

(Fatir: 19-20)

I Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) thotë: “Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman”. Dituria e kërkuar nuk është vetëm në diturinë e fesë, por në çdo lloj diturie të dobishme që kanë nevojë muslimanët në dunjanë e tyre, sepse kërkimi apo mësimi i saj është farz kifaje, siç ka thënë Gazali, Shatibi e dijetar të tjerë si këta të dy.

Niveli normal për jetesë:

Dhe nga kjo bëhet e qartë se qëllimi i dhënies së zekatit nuk është dhënia e të varfërit disa derhem të numëruara, por është që të realizojë apo të arrijë i varfëri një nivel normal jetese. Dhe grada më e ultë e këtij niveli njerzor është që t'i mundësojë atij dhe familjes të ushqyer normal, veshmbathjen e dimrit dhe verës dhe një vendbanim e meriton gjendja e tij. Kjo është ajo që ka përmendur Ibën Hazmi dhe shumë dijetarë të tjerë, dhe kërkon të shikohet me vëmendje, se niveli i jetesës së një personi nuk përcaktohet me kufi të prerë, sepse ai ndryshon sipas kohërave dhe mjedisëve.

Zekati është i pari sigurim social në botë:

Vërtetë zekati konsiderohet i pari ligj i rregullt në rrugë të sigurimit social dhe nuk mbështetet në lëmshat individuale vullnetare, por ngrihet mbi ndihmat shtetërore të rregullta, ndihma, qëllimi i të cilave është realizimi i nevojave për çdo nevojtar.

IV - ASISTENCA E DEPOZITËS ISLAMIKE ME TË ARDHURAT E SAJ TË NDRYSHME

Ndonëse më parë sqaruam se, zekati është i pari burim shtetëror i të ardhurave që përdoret për kurimin e varfërisë, depozita e shtetit islam përdor edhe të ardhura të tjera për këtë punë. Shteti ka në zotërim pasuri të përbashkëta që i shfrytëzon vetë, apo i jep me qera, siç janë (sipas mendimit më të saktë) vakëfet publike, pasurit minerale, ujore etj, të ardhurat e tyre futen në buxhetin e shtetit që të përfitojnë të gjithë nënshtetasit, midis tyre edhe të varfërit. Po ashtu edhe nga plaçka e luftës, haraçi dhe taksa të tjera kanë pjesë të varfërit.

“Mos u bëni si ata që dolën prej shtëpive të tyre sa për krenari e për t’i parë bota, e që pengonin nga rruga e All-llahut. All-llahut nuk mund t’i shpëtojnë me atë veprim të tyre.”

(Enfal: 47)

“Atë që All-llahu nga banorët e vendeve (jobesimtare) ia dha pa luftë të dërguarit, të vet, ajo i takon All-llahut, të dërguarit, të afërmve, jetimëve, të varfërve, kurbetçinjve. (Kështu veprohet) Që ajo të mos ndahet ndërmjet pasanikëve tuaj. Çka t’ju jep Pejgamberi, atë merreni e çka t’ju ndalojë, përmbanju dhe keni frikë All-llahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër.”

(Hashr: 7)

Pra individët e një shoqërie nuk janë vetëm elemente ekonomike jo!

Kurrsesi sepse shoqëria në këndvështrimin e Islamit është një familje e lidhur mes individëve dhe grupeve të saj, lidhje kjo më e thellë dhe më e fuqishme se lidhjet e prodhimit ekonomik, lidhje themeli së cilës është Islami. Ai i bashkon të gjithë në njëshmërinë e akides (besimit) dhe mendimit, në njëshmërinë e ndjenjave e mëshirës. Në njëshmërinë e rregullit dhe ligjit, dhe në njëshmërinë e kësaj bote dhe të botës tjetër. Për këtë, Islami e përshkruajti shoqërinë si një trup të vetëm dhe çdo gjymtyrë ose qelizë në këtë trup, është e lidhur me pjesët e tjera, jep dhe merr prej tyre. Vërtet, nga detyrat e para të një shteti Islam është që të realizojë drejtësinë, të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja. Nuk është nga drejtësia dhe as nga mirësia që të uriten të dobët ose të privohen të varfërit nga nevojat themelore të jetës, si ushqim, veshmbathje dhe vendbanim. Por, duhet që shteti Islam të përdorë të gjitha mënyrat që të kurojë problemin e varfërisë dhe të sigurojë jetë normale për të varfërit dhe të realizojë asistencë sociale në shoqëri, dhe këto mënyra ndryshojnë sipas ndryshimit të kohërave, mjediseve dhe gjendjeve.

V - DETYRIMI I TË DREJTAVE TJERA POS ZEKATIT

Muslimani ka gjithashtu, disa detyrime të tjera financiare, të cilat mund të shfrytëzohen për t'i ardhur në ndihmë të varfërve. Nga këto të drejta janë:

Kemi të drejta të tjera pasurie që duhen për muslimanin për shkaqe të ndryshme, të gjitha si rrjedhojë për ndihmimin e të varfërve dhe largimin e varfërisë. Dhe nga këto të drejta:

1. E drejta e fqinjit,

All-llahu urdhëroi për kujdesjen ndaj tij. Këtë e nxiti edhe i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) në sunnetin e tij, ku e bëri nderimin e fqinjit pjesë të imanit (besimit) dhe dënimin e tij ose neglizhencën ndaj tij nga argumentet e largimit nga Islami. All-llahu xh.sh. thotë:

“Adhuroni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, sillnu mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.”

(Nisa: 36)

Ndërsa i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) thotë:

“Kush beson në All-llahun dhe Ditën e Gjykimit le të respektojë apo të nderojë fqinjët e tij.”

“Sillu mirë me fqiu tënd që të jesh musliman.”

“Xhibrili më këshilloi aq shumë për fqiu, derisa mendova se ai do ta bënte trashëgimtar.”

“Nuk është besimtar ai që fle i ngopur, ndërkohë fqiu i tij në anën tjetër i uritur dhe ai ka dijeni për këtë.”

2. Kurbanët në festën e Kurban Bajramit:

Prerja e kurbanit është detyrë në medhhebin e Ebu Hanifes, për atë që ka mundësi duke u bazuar në hadithin: “Kush ka mundësi dhe nuk pret kurban mos t’i afrohet vendfaljes sonë.”

3. Gënjeshtër në betim:

All-llahu xh.sh. thotë:

“Sikur të ishin ata që vërtet e besojnë All-llahun, Pejgamberin dhe atë që i zbriti atij, nuk do t’i zinin për miq ata (idhujtarët), por shumica prej tyre janë fasika (mëkatarë).”

(Maide: 81)

4. Dëmshpërblimi i dhiharit:

Kush i thotë bashkëshortës së tij: Ti për mua je si shpina e nënës sime ose e motrës sime, ose një shprehje të tillë si kjo, gruaja e tij është e ndaluar për të derisa të japë dëmshpërblimin dhe dëmshpërblimi i tij është lirimi i një robi. Kush nuk gjen, atëherë të agjëroj dy muaj rresht, dhe kush nuk mundet, duhet të ushqejë 60 të varfër.

5. Dëmshpërblimi i marrëdhënies seksuale

Dëmshpërblimi i marrëdhënieve seksuale në ditën e Ramazanit është i njëjtë me dëmshpërblimin e dhiharit.

6. Dëmshpërblimi i një të moshuari dhe të moshuare, i një të sëmuri, i cili nuk shpresohet shërimi i tij dhe i të gjithë atyre që nuk kanë mundësi të agjërojnë. Ata si dëmshpërblim kanë që të ushqejnë çdo ditë Ramazani një të varfër.

“(jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aqë më mirë për te. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju.”

(Bekare: 184)

Të njëjtin dëmshpërblim kanë gruaja shtatzënë dhe nëna që i jep gji fëmijës, nëse frikësohen për vete ose për fëmijët e tyre, siç është medhhebi i disa fukahave.

7. Hedju (dhurata - kurban): Ajo është çka i dhuron haxhiu ose ai që bën umre Qabes prej deveve, lopëve apo deleve, si dëmshpërblim për një thyerje të një obligimi nga obligimet e ihramit. All-llahu xh.sh. thotë:

“O ju që besuat, mos e mbytni gjahun, duke qenë ju në ihram. E kush e mbyt atë me qëllim, atëherë dënimi është prerja e një kafshe shtëpiake të ngjashme me atë (të egtën) që e ka mbytur. Për këtë çështje vendosin dy njerëz të drejtë nga mesi juaj, duke bërë at kurban për Qabe, ose (dënimi është) duke ushqyer të varfër, ose sa ai (ushqimi), agjërim, këtë për ta shijuar të keqen e punës së tij. All-llahu ka falur të kaluarën. E kush bën përsëri, (gabimin) All-llahu dënon ashpër. All-llahu mbizotëron (çështjet), hakmerret (me dënim).”

(Maide: 95)

“E kryeni haxhin dhe umren për hir të All-llahut, po në qoftë se pengoheni, atëherë (therrni për kurban) çka t’ju vijë më lehtë prej kurbanëve, e mos i rruani kokat tuaja derisa të arrijë kurban vendin e caktuar. Po kush është prej jush i sëmurë ose ka mundim koke (e rruhet para kohe) kompensimi është: agjërim, sadaka ose kurban. E kur jeni të sigurt, ai që bënë umrën para haxhit

(duhet therrë) një kurban që i vjen më lehtë, mirëpo nëse nuk ka, le të agjëroj tri ditë gjatë haxhit e shtatë ditë kur të ktheheni, këto jeni dhjetë ditë të plota. Ky është rregull për ata që nuk kanë familjen pranë xhamisë së shenjtë. Pra keni dro All-llahun dhe dine se All-llahu është ndëshkues i rreptë.”

(Bekare: 196)

8. Të drejtat e të korrurave: All-llahu xh.sh. thotë:

“Ai (All-llahu) është që krijoi kopshte (bimët e të cilave) të ngritura lart (në shtylla) dhe të rrafshta (të shtrira në tokë), edhe hurmet dhe drithërat me frute (shije) të ndryshme, (krijoi) ullinj të dhe shegët e ngjashme (nga shija). Hani frutat e tyre kur të piqen dhe ditën e korrjes (të vjeljes) së frutave jepni atë pjesë që është obligim (të varfërve e nevojlive) dhe (hani-jepni) mos teproni, pse Ai nuk i do shkapërderdhësit.”

(En’am: 141)

VI - LËMOSHA VULLNETARE DHE BAMIRËSIA INDIVIDUALE

Mbi të gjitha këto të drejta të obliguara dhe ato të ligje të detyruara, Islami punoi për krijimin e një njeriu të zgjedhur e bamirës, që jep dhe sakrifikon, një njeri që jep pa kërkuar apo lypur, që jep në rehati dhe vështirësi ,natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, që dëshiron për njerëzit atë që dëshiron për veten e tij; që e konsideron pasurinë mjet e jo qëllim. Këtu kanë ardhur versetet e Kur’anit famëlartë dhe hadithet e të Dërguarit të All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem)

përgëzuese, nxitëse dhe frikësuese, që bëjnë thirrje për dhënie, dhe ndalojnë nga koprracia, që me përshkrimet më të mrekullueshme dhe stilet më të larta artistike shkrin ngricën e zemrave të ngrira prej mëkatëve dhe lëviz duart që vetëm marrin duke i bërë të japin. Do të mjaftohemi me shembuj të paktë të Kur'anit dhe haditheve, edhe pse ato janë të shumta All-llahu xh.sh. thotë:

“Kush është ai që i huazon All-llahut një hua të mirë, e Ai t’ia shtojë atij shumëfish atë? All-llahu shtrëngon (varfëron) dhe çliron (begaton) dhe kthimi juaj është vetëm tek Ai.”

(Bekare: 245)

“Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. All-llahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, All-llahu është Bujar i Madh, i di qëllimet.”

(Bekare: 261)

“Ata që për hir të All-llahut e japin pasurinë e tyre, e pastaj atë që e dhanë nuk e përcjellin me të përmendur e me mburrje, ata e kanë shpërblimin e vet të Zotit i tyre, për ata nuk ka frikë, ata as që do të brengosen.”

(Bekare: 262)

“Ata, të cilët pasurinë e vet e shpërndajnë (në rrugë të Zotit) natën e ditën, fshehurazi ose haptazi, ata shpërblimin e vet e kanë të Zotit i tyre dhe për ta nuk ka as frikë, as pikëllim.”

(Bekare: 274)

“Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për në Xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. Të cilët japin kur janë

shlirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit.”

(Ali Imran: 133-134)

“Thuaj: “S’ka dyshim se Zoti im është Ai që i jep furnizim të begatshëm atij që do nga robërit e vet dhe Ai ia pakëson atij, e çkado që të jepni, Ai e kompenson atë dhe Ai është dhuruesi më i madh.”

(Sebe’: 39)

“Besoni All-llahut dhe të dërguarit të Tij dhe jepni nga ajo që Ai u bëri trashëgues në të, se ata që besuan prej jush dhanë për hir të Zotit, ata kanë shpërblim të madh.”

(Hadid: 7)

“Edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin te ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.”

(Hashr: 9)

“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varvërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimet) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë vështirë.”

(Munafikun: 8-10)

Ndërsa i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): thotë: “Robi thotë: Pasuria ime, pasuria ime. i mbetet prej saj veçse tri pjesë: pjesa që e shpenzoi për të ngrënë, pjesa që e shpenzoi për t’u veshur dhe pjesa që e dha për bamirësi. Ndërsa pjesa e mbetur do t’i takoj njerëzve, kur ai ta lë këtë botë.”

I Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) thotë:

“Sadakaja e fshin gjynahin, ashtu siç e shuan uji zjarrin”. Ai thotë: “Çdo njeri është nën hijen e sadakasë së tij (në ditën e gjykimit) derisa të gjykohet mes njerzëve.”

VAKËFI I BAMIRËSISË:

Nga gjërat më të rëndësishme që ka nxitur Islami ishin lëmoshat që u njohën me emrin: sadaka e përhershme, islami i dha asaj një shpërblim të dalluar nga të tjerat për vazhdimësinë e ndikimit të saj dhe përhershmërinë e dobisë së saj.

Shpërblimi i saj është i përhershëm dhe i qëndrueshëm për të zotin e saj edhe pas vdekjes së tij, përderisa të jetë dobija e saj. Dhe për këtë transmeton Ebu Hurejre se, i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Nëse vdes njeriu ndërpritet puna e tij, përveçse në tri gjëra: sadakaja e përhershme, dituria që sjell dobi me të dhe fëmija i mirë që lutet për të”.

KONKLUZION

Këto janë gjashtë mënyrat, me të cilat Islami kuroi problemin e varfërisë. Mund t'i përmbledhim ato në tri pika apo në tri mënyra kryesore:

Pika e parë: Lidhet me vetë personin e varfër, dhe ajo është obligueshmëria e punës kur t'i krijohet mundësia dhe kur të jetë i zoti. Shoqëria dhe shteti kanë obligim kujdestarinë dhe ndihmesën e tij me para dhe trainime derisa të gjejë punën e përshtatshme.

Pika e dytë: Ka të bëjë me shoqërinë muslimane, e cila mer përsipër asistencën e të varfërve duke iu nënshtruar ligjit të detyrimit ose duke iu përgjigjur dëshirës së shpërblimit tek All-llahu. Kjo asistencë merr trajtat e mëposhtme:

- a) Shpenzimi për të afërmit
- b) Ruajtja e të drejtave të fqinjëve
- c) Dhënia e zekatit të obliguar, nëse nuk e merr atë shteti musliman.
- d) Kryerja e obligimeve të përkohshme në pasuri, si dëmshpërblimi i betimeve, ndihma e të detyruarit, plotësimi i nevojës së nevojtarit etj....
- e) Sadakatë vullnetare të përkohshme ose të përhershme.

Pika e tretë: është e veçantë për shtetin musliman, i cili duhet që me ligj të marrë përsipër plotësimin e nevojave të çdo nevojtares që nuk ka të ardhura, pa marrë parasysh a është musliman apo dhimmij.

Një kusht i domosdoshëm

Këto mënyra, të cilat i sqaruar mësipër dhe me të cilat Islami e kuroi problemin e varfërisë e realizojnë qëllimin e tyre dhe i japin frytet e tyre në mënyrë të kënaqshme nën hijen e shoqërisë Islame që drejton besimi Islam dhe gjykon me rregullat e Islamit, që rri nën hijen e shariatit të tij të pastër në jetën e tij ekonomike dhe sociale, politike dhe kulturore. Vërtet rregulli islam për jetën dhe shoqërinë është rregull i plotë, që nuk e lejon copëzimin e tij dhe as marrjen e një pjese prej tij dhe lënien e pjesës tjetër sepse mund të jetë ajo që ka lënë kusht i asaj që ka marrë për këtë. All-llahu i lartësuar urdhëroi hyrjen në Islam plotësisht dhe pranimin e të gjitha kushteve të tij kur thotë:

“O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (Përqafoni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik i juaj i hapët.”

(Bekare: 208)

Dhe jo siç dëshiruan disa çifutë që të hyjnë në Islam duke ruajtur disa tradita të hershme. All-llahu i tërhoqi vëmendjen të Dërguarit të Tij nga idhtarët e librit që dëshiruan ta shmangin atë nga disa ligje të kësaj feje. All-llahu xh.sh. thotë:

“(Ta zbritëm) Që edhe ti të gjykosh me atë që të zbriti All-llahu, e mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruaju rrezikut të tyre që mos të shmangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti All-llahu. Nëse ata refuzojnë (gjykimin tënd), ti dije se All-llahu ka për qëllim t’i ndëshkojë për disa mëkate të tyre. Në të vërtetë, një shumicë e njerëzve janë jashtë rrugës.”

(Maide: 49)

Prandaj marrja vetëm e një pjese të rregullit Islam është dalje nga logjika Islame e cila e refuzon copëzimin.

Rregulli islam shton prodhimin dhe i pakëson të varfërit:

Vërtet natyra e rregullit islam obligon shtimin e prodhimit për popullin dhe ruajtjen e pasurisë së tij nga shpërdorimi i saj në atë çka nuk sjell dobi. Islami i ruan fuqitë e tija pasuritë e tij dhe sakrificat e bijve të tij që të mos konsumohen në pirjen e alkoolit dhe në punët e ndyra, e të fshehta.

Islami i mbron energjitë dhe pasuritë e një shoqërie nga shpërdorimi i tyre në punë të kota e të ndyra duke imponuar ligje, duke e udhëzuar dhe edukuar atë, duke formuar individin e shëndoshë që i përkushtohet punës, prodhimit dhe zhvillimit.

Vërtet ai popull i cili e fillon ditën e tij nga sabahu i hershëm me abdes duke u falur, me shpirt të mirë dhe aktiv, me moral të drejtë dhe të mirë do të jetë më i mirë dhe më i lartë prodhimi i tij, sesa prodhimi i një populli që e kalon gjysmën e natës apo të shumtën e saj në imoralitet, në alkool apo në fëlliqësira të ndryshme, dhe nëse e zë atë sabahu nuk ngrihet nga gjumi i tij përveçse me urrejtje, dhe nëse drejtohet në punën e tij drejtohet me shpirt të ligë, me dembelizëm

dhe i pafuqishëm. Natyra e rregullit islam shton në pasurinë e shoqërisë dhe e pakëson masën e të varfërve në të, dhe sa më shumë që të pakësohet numri i të varfërve në një popull dhe të shtohet pasuria e tij, aq më shumë i përmbahen të pasurit rrugës së drejtë në dhënie dhe konsum. Atëherë edhe problemi i varfërisë dhe i të varfërve, do të jetë më i lehtë, dhe më i lehtë kurimi i tij, madje as që nuk shfaqet një problem i tillë.

Rregulli Islam është i plotë që nuk copëzohet:

Në realitet, rregulli Islam, në aspekte të ndryshme, është një dhe nuk ndahet. Rregulli Islam e konsideron pasurinë në të vërtet pasuri të All-llahut dhe e konsideron zotëruesin e saj si një besnik apo mbikqyrës mbi këtë pasuri. Ky rregull e ndalon shpërdorimin e pasurisë dhe i bëri shpërdoruesit vëllezër të shejtanëve.

Nderi i të varfërve është i ruajtur:

Sidoqoftë varfëria nuk prek nderin e të varfërit në shoqërinë islame dhe nuk humb nga të drejtat e tij qoftë edhe një grimcë. Islami i mësoi bijtë e kësaj shoqërie se nderimi dhe grada e lartë nuk është në pasuri, por me dituri dhe besim. All-llahu xh.sh. thotë:

“(A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimt të) botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”

(Zumer: 9)

“O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”

(Huxhurat: 13)

“O ju që besuat, kur t’ju thuhet: zgjerohuni (bëni vend) në vend ndeje, zgjerohuni, se All-llahu bën zgjërime për ju, e kur t’ju thuhet: ngrihuni! Atëherë ju ngrihuni, All-llahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni.”

(Muxhadel: 11)

“Nuk është i barabartë i verbëri dhe ai që sheh, e as ata që besuan dhe bënë vepra të mira, nuk janë të barabartë me të këqijtë, por pak jeni duke marrë mësim.”

(Gafir: 58)

Njerëzit në shoqërinë arabe në kohën e injorancës, i peshonin apo i barazonin të tjerët sipas pasurisë që kishin, deri sa e refuzuan edhe pejgamberllëkun e Muhammedit (sal-Allahu alejhi ve sel-lem) në fillimin e tij, sepse ai ishte i varfër dhe dëshiruan që shpallja të zbriste mbi njërin nga dy burra të pasur e të njohur në Mekke ose në Taif: Elvelidj Ibnul-Mugireti kureshi dhe Urvetu ibën Mesud Eth-thekafi:

“Pastaj thanë: “Përse të mos i ketë zbritur ky Kur’an një njeriu të madh nga dy qytete?”

(Zuhruf: 31)

Kur erdhi Islami, i shkatërroi këto kritere të padrejta dhe bëri të qartë se, vlera i njeriut është në besimin dhe në veprën e tij dhe jo në dhjamin dhe mishin e tij, e as në arin dhe argjendin e tij dhe as në veshmbathjen e tij dhe bukurinë e tij. Thotë i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Burri i madh dhe i shëndoshë në ditën e gjykimit nuk peshon tek All-llahu sa njëri krah i mushkonjës”. Dhe lexoni nëse dëshironi.

“Të tillët janë ata që nuk besuan argumentet e Zoit të tyre as takimin (ringjalljen) e Tij, andaj veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e gjykimit atyre nuk do t’u jepet kurrfarë vlere.”

(Kehf: 105)

MBYLLJE

TRIUMFI I ISLAMIT MBI VARFËRINË

Nëse njerëzit besojnë më shumë tek praktika se sa tek dituria atëherë ne do të përmendim këtu disa shembuj të gjallë që i ka regjistruar historia për triumfin e rregullit islam ndaj varfërisë e frikës, dhe realizimin e bollëkut dhe sigurisë nën hijen e lirisë. Dhe ajo që është e çuditshme se, për këtë bollëk dhe siguri ka lajmëruar i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem), kur u njoftua me shpallje nga Zoti i tij. Le të sjellim disa tekste argumentuese për fshirjen ose eliminimin e varfërisë nga shoqëria islame. Transmeton Buhari dhe të tjerët nga Harithe ibën Vehb el- Huzai, thotë: Kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) duke thënë: “Jepni sadaka, sepse do t’ju vijë një kohë që ka për të ecur burri me sadakanë e tij dhe nuk ka kush e merr atë dhe thotë, sikur të vijë dje do ta kisha marrë atë, ndërsa sot nuk kam nevojë për të”. Transmeton Buhariu gjithashtu nga Ebu Hurejre që thotë: Ka thënë i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem): “Nuk do të vijë kijameti, derisa të shumohet pasuria mes jush dhe i zoti i pasurisë të vendosë të japë sadaka, por atij që iu afron e refuzon duke thënë. Nuk kam nevojë për të.”

Transmeton gjithashtu Buhariu nga Ebu Musa el-Esh’ari nga i Dërguari i All-llahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) se ka thënë: “Do të vijë për njerëzit një kohë që do të sillen burri dhe në dorën e tij sadakaja prej ari, dhe nuk do të gjejë njeri që ta marrë atë”. Nuk zgjati shumë kjo kohë derisa

arritën muslimanët pasuri dhe nuk gjendej në shoqërinë e tyre kush e meriton sadakanë dhe kjo ndodhi kur u zbatua ligji i drejtë dhe halifeti i drejtë, pra ndodhi në kohën e Umer Ibn Abdul-Aziz (r.a.). Kështu arriti bollëku dhe pasuria nën hijen e drejtësisë së Islamit në një kufi të tillë çdo njeri kishte të drejtë të merrte nga depozita e shtetit pa dredhi. Arriti çdo borxhli të gjejë nga pasuria e shtetit ç'farë i duhet që ta shlyejë borxhin e tij dhe arriti çdo beqar të marrë nga shtëpia e pasurisë së muslimanëve, aq sa të marthohet dhe të ndërtojë me të familje. Ebu Ebejde na transmeton një lajm ku thotë: “Muadh Ibn Xhebel, kur ishte ushtarë e dërgoi i Dërguari i Allahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) në Jemen, derisa vdiq i dërguari i Allahut (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) dhe Ebu Bekri. Pastaj erdhi Umeri dhe e ktheu prap atë në Jemen. Muadhi 1/3 e sadakasë së njerëzve dhe Umeri nuk e pëlqeu këtë dhe tha: “Nuk të kam dërguar ty marrës së taksave, por të kam dërguar që të marrësh nga njerëzit e pasur dhe ta kthesh atë tek të varfërit e tyre!!

Muadhi tha: Atë që ta kam dërguar ty nuk kam gjetur kënd që ta marrë. Vitin e dytë Muadhi dërgoi tek Umeri gjysmën e sadakasë dhe Umeri bëri të njëjtin dialog si në vitin e parë, në vitin e tretë Muadhi dërgoi tek Umeri të gjithë sadakanë, Umeri bëri të njëjtin dialog me të dhe i tha Muadhi, nuk kam gjetur askënd që të marrë gjë nga unë. “Për Zotin, ku ka më të madhërisëm dhe më të mrekullueshëm se ky lajm!!”

Muslimanët në të gjitha kontinentet janë një popull i vetëm. Këto janë disa fryte, të cilat i dha praktikimi i rregullit islam, kur iu dha atij mundësia në disa vende dhe disa kohëra.

Nga këta shembuj real, na bëhet e ditur gabimi i atyre që mendojnë se fukarallëku është sëmundje që nuk ka ilaç për të dhe na bëhet e ditur gabimi i atyre që mendojnë se legjitimi i zekatit në Islam

është pohim zyrtar për domosdoshmërinë e ekzistencës së varfërisë dhe të varfërve në shoqërinë islame. Jo, kurrsesi varfëria nuk është diçka e pashmangshme në shoqërinë muslimane, por është çështje emergjente, i paraqitet shqërisë muslimane ashtu siç i paraqitet çdo shoqërie. Mund të vijë një ditë që shkatrohen të gjitha bagazhet e varfërisë, shpërthejnë në shoqëri burimet e pasurisë dhe gëzojnë njerëzit një jetë të sigurtë e të qetë. Furnizimi iu vjen atyre nga çdo anë dhe çdo vend dhe ndërpriten shkaqet e ankimit nga varfëria, uria dhe frika. Atëherë drejtohet zekati tek merituesit e tjerë, atyre që u duhet përfituar zemra (të dobëtve në besim), për lirim nga robëria, të mbyturve me borxh (luftëtarëve) në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë.